

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji "Për njohjen e kualifikimeve profesionale të fituara në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, Zonës Ekonomike Evropiane dhe Konfederatës së Zvicrës, si dhe për vlerësimin e proporcionalitetit të rregullave për aksesin dhe ushtrimin e profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë !"
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Arsimit (MA)
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm/transpozim i BE-së/ndërkombëtar
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva 2005/36/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shtator 2005, për njohjen e kualifikimeve profesionale, (FZ L 222, 30.9.2005, p.22, e ndryshuar); Direktiva (BE) 2018/958 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 28 qershor 2018 mbi testin e proporcionalitetit përpara miratimit të një rregullimi të ri për profesionet (FZ L 177, 09.7.2018, p.25).
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 11.1.2024 ("PKIE") Kapitulli 3 i negociatave për anëtarësim në BE – "Liria e Vendosijes dhe Ofrimi i Shërbimeve"
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Data/Asnjë konsultim publik.
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Data e vlerësimin të ndikimit
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo Data e shqyrtimit
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i>	

Natyra e problemit ka karakter legjislativ që lidhet me nevojën për të përafruar kuadrin ligjor vendas me parashikimet e Direktivës 2005/36/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shtator 2005, mbi njohjen e kualifikimeve profesionale, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 255, datë 30.9.2005, e ndryshuar me: Direktivën 2013/55/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 nëntor 2013, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 354/132, datë 28.12.2013; Direktivën (BE) 2024/505 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shkurt 2024, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 2024/505, datë 12.2.2024 (referuar në vijim si “Direktiva 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale” ose thjesht “Direktiva 2005/36/KE”) si dhe te Direktivës (BE) 2018/958 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 28 qershor 2018, mbi testin e proporcionalitetit përpara miratimit të rregullave të reja për profesionet, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 173, datë 09.07.2018. (referuar në vijim si “Direktiva (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit” ose thjesht “Direktiva (BE) 2018/958”).

Për më tepër, kuadri aktual ligjor karakterizohet nga fragmentarizimi i legjislacionit dhe mungesa e koherencës, sidomos në rastet kur njohja e kualifikimeve kërkohet nga Shqipëria drejt vendeve anëtare të BE-së (ku vendi ynë është në cilësinë e “shtetit të origjinës”), çka tregon për nevojën e një qasjeje më të unifikuar dhe të harmonizuar për të garantuar zbatimin efektiv të parimeve të përcaktuara në Direktivat përkatëse.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet miratimit të kësaj politike janë:

- Përafrimi i plotë i kuadrit ligjor vendas me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit, në kuadër të detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë me qëllim anëtarësimin në Bashkimin Evropian (“BE”);
- Realizimi i masës përkatëse në PKIE 2024-2026, brenda tremujorit të tretë të vitit 2025;
- Krijimi i një kuadri plotësisht të harmonizuar me standardet e BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale në profesionet e rregulluara, si dhe vendosja e një kuadri analitik për zbatimin e testit të proporcionalitetit gjatë hartimit të rregullave të reja për profesionet, në përputhje me *acquis* të BE-së.
- Zbatimi i angazhimeve të ndërmarra në kuadër të marrëveshjeve rajonale për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale për profesionet sektoriale;

Krijimi i premisave për lëvizjen e lirë të profesionistëve brenda territorit të Bashkimit Evropian nëpërmjet njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, me efekt nga momenti i anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 0² – (jo rregullator) – Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues. Nuk gjen zbatim si pasojë e detyrimit për harmonizim, si parakusht për anëtarësimin në BE.

Opsioni 1 – Ndërhyrje të targetuara në aktet ligjore sektoriale pjesë e kuadrit rregullator ekzistues, me qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit sektorial me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit. Vlerësohet i kushtueshëm në kohë dhe në aspektin e koordinimit ndërinstitucional dhe rrezikon fragmentim të mëtejshëm të legjislacionit dhe mungesë koherence në zbatim.

Opsioni 2 (i preferuar) – Hartimi i një ligji të ri, të harmonizuar plotësisht me parashikimet e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit;

Opsioni 3 – Hartimi i dy ligjeve që do të transpozojnë përkatësisht parashikimet e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit. Vlerësohet se kërkon më shumë burime administrative dhe rrezikon mbivendosje të kompetencave midis institucioneve zbatuese, po ashtu rrezikon anashkalimin dhe zbehjen e rëndësisë së Direktivës (BE) 2018/958.

Opsioni 4 – Transpozimi i Direktivës 2005/36/KE me ligj të ri të veçantë dhe i Direktivës 2018/958/BE përmes ndryshimeve në Ligjin nr. 10 171/2009 “Për profesionet e rregulluara” Ky opsion vlerësohet se kërkon më shumë burime administrative, për shkak të nevojës për ndryshime në disa akte ligjore dhe të akte nënligjore duke ndikuar në fragmentarizim të mëtejshëm, si dhe krijon pasiguri në garantimin e zbatimit të duhur të klauzolave që rregullojnë bashkëpunimin administrativ në nivel evropian.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Si grupe të prekura nga përafrimi tërësor i kuadrit ligjor vendas me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit janë parashikuar qeveria dhe autoritetet publike, profesionistët, urdhrat profesionalë, IAL-të, studentët dhe profesionistët e kualifikuar të ardhshëm, punëdhënësit/bizneset vendase, si edhe qytetarët si përfitues shërbimesh.

Për qeverinë dhe autoritetet publike ndikimet e drejtpërdrejta përfshijnë përshtatje të rëndësishme legjislative, sfida në shpërndarjen e burimeve, si dhe nevojën për zbatimin e trajnimeve gjithëpërfshirëse për shkak të futjes së testit të proporcionalitetit dhe sistemit të ri të njohjes së kualifikimeve.

Nga perspektiva e tregut dhe e shtetit, ndikimet e tërthorta përfshijnë përparim të ndjeshëm në shkallën e përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së, si dhe rritje të efekteve financiare në buxhetin e shtetit. Ndikime të tërthorta janë gjithashtu zhvillimi ekonomik brenda tregut rajonal dhe atij evropian nëpërmjet vendosjes së parimeve bazë për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale.

² Bazuar në parashikimet e Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit, e cila përcakton mënyrën sesi duhet të hartohen Raportet e Vlerësimit të Ndikimit, e miratuar me VKM nr. 584 datë 28.08.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar, në rastin e VN-ve për projektligje që transpozojnë pjesërisht apo plotësisht *acquis* të BE, opsioni 0 (status quo) nuk përfshihet në analizë, pasi ekziston detyrimi (angazhimi) për harmonizimin

Gjithashtu, vendosja e një kuadri analitik për zbatimin e testit të proporcionalitetit, në përputhje me Direktivën (BE) 2018/958, si një masë *ex-ante* për rregulloret e reja që lidhen me profesionet, pritet të garantojë minimizimin e rregullimeve të tepërta që mund të ndikojnë në ushtrimin e lirë të profesioneve të rregulluara dhe të ndihmojë në shmangien e pengesave burokratike ndaj lëvizjes së lirë të profesionistëve të kualifikuar.

Në aspektin territorial, zonat rurale dhe më pak të zhvilluara do të përfitojnë nga rritja e aksesit në profesionistë të kualifikuar, çka ndihmon në reduktimin e pabarazive rajonale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Sa i përket rrezikut të emigracionit të trurit (*brain drain*), përfshirja e mekanizmave për përmirësimin e kushteve të punës dhe sistemit të shpërblimit në vend pritet të balancojë këtë efekt, duke ndihmuar në ruajtjen dhe rikthimin e profesionistëve të kualifikuar dhe në forcimin e konkurrueshmërisë së tregut vendas të punës.

Për profesionistët, ndryshimet e propozuara do të lehtësojnë drejtpërdrejt aksesin në tregun e punës në Shqipëri për profesionistët e kualifikuar nga vendet e tjera të BE-së, dhe anasjelltas. Në mënyrë të tërthortë, rritja e pritur e konkurrencës pritet të nxisë ofrimin e shërbimeve me cilësi më të lartë dhe të inkurajojë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të ofruesit e shërbimeve.

Në të njëjtën kohë, parashikohet që një pjesë e profesionistëve të shohin mundësi për të ushtruar profesionin në vende të tjera të BE-së, të tërhequr nga kushte më të favorshme pune apo përfitime më të mira financiare. Kjo dinamikë pritet të krijojë një shtysë pozitive për tregun vendas, duke nxitur përmirësimin e kushteve të punës dhe të sistemit të shpërblimit, me synim ruajtjen dhe tërheqjen e profesionistëve të kualifikuar.

Për institucionet e arsimit të lartë Për institucionet e arsimit të lartë, pritet një ndikim i drejtpërdrejtë në përparimin e përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në VKM nr. 41/2018, si dhe në zhvillimin e kurrikulave të përshtatshme për të përfshirë kërkesat minimale për profesionet sektoriale. Në mënyrë të tërthortë, kjo pritet të rrisë reputacionin dhe njohjen e institucioneve shqiptare të arsimit të lartë, duke tërhequr potencialisht më shumë studentë të huaj dhe duke dekurajuar studentët shqiptarë nga ndjekja e studimeve jashtë vendit.

Për urdhrat profesionalë ndikimi i drejtpërdrejtë lidhet me nevojën për të përshtatur dhe harmonizuar praktikën dhe standardet e tyre me homologët përkatës në Bashkimin Evropian, me qëllim lehtësimin e heqjes së pengesave për ushtrimin e profesioneve të rregulluara, si në nivel rajonal ashtu edhe në hapësirën e BE-së. Ky harmonizim do të përmirësojë qasjen në tregje të reja pune dhe do të lehtësojë njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve.

Në mënyrë të tërthortë, ky proces pritet të nxisë bashkëpunimin ndërinstitucional me urdhrat profesionalë të vendeve të BE-së, duke sjellë shkëmbim të praktikave më të mira, përvojave rregullatore dhe njohurive teknike, çka do të kontribuojë në përmirësimin e standardeve të brendshme dhe të cilësisë së shërbimeve profesionale.

Për studentët dhe profesionistët e ardhshëm të kualifikuar, politika e propozuar zgjeron drejtpërdrejt mundësitë për të ushtruar profesionin e tyre në vendet e BE-së, duke lehtësuar njohjen e kualifikimeve të fituara në Shqipëri. Kjo pritet gjithashtu të nxisë interesin për të ndjekur studime dhe karriera në profesionet e rregulluara, falë përmirësimit të perspektivave për mobilitet profesional brenda rajonit dhe BE-së.

Zbatimi i Direktivës për proporcionalitetin do të ndikojë në krijimin e rregullave më të qarta, jodiskriminuese dhe proporcionale, duke e bërë më të lehtë aksesin në profesionet e rregulluara. Nga ana tjetër, kurrikulat do të pësojnë përshtatje, duke bërë që procesi i formimit profesional të

bëhet më kërkuar. Megjithatë, kjo do të sjellë një cilësi më të lartë të edukimit dhe përgatitjes profesionale, duke u dhënë profesionistëve shqiptarë avantazhe më të mëdha në një treg pune gjithnjë e më konkurrues.

Për punëdhënësit vendas, politika e propozuar do të rrisë drejtpërdrejt numrin e profesionistëve të kualifikuar të disponueshëm për pozicione që kërkojnë aftësi teknike dhe kualifikime të specializuara, duke reduktuar potencialisht kostot dhe kohën e rekrutimit. Gjithashtu, punëdhënësit mund të presin rritje të konkurrencës dhe inovacionit, falë aksesit në një gamë më të gjerë aftësish dhe ekspertize, si dhe thjeshtimit të procedurave për punësimin e profesionistëve të kualifikuar nga vendet e BE-së.

Megjithatë, me rritjen e mobilitetit profesional, pritet që një pjesë e profesionistëve më të kualifikuar të zgjedhin të punojnë në vende të tjera të BE-së, të tërhequr nga kushte më të mira pune apo pagesa më të larta. Ky largim i mundshëm i talenteve mund të krijojë boshllëqe të përkohshme në tregun vendas të punës. Për ta adresuar këtë, politika pritet të krijojë një efekt nxitës pozitiv mbi tregun e brendshëm të punës, duke e shtyrë atë të përmirësojë kushtet e punës, të rrisë standardet e pagesës dhe të investojë më shumë në zhvillimin profesional. Këto përmirësime do të ndihmojnë jo vetëm në ruajtjen e profesionistëve të kualifikuar, por edhe në forcimin e konkurrueshmërisë së Shqipërisë për të tërhequr talente si në nivel rajonal, ashtu edhe në atë evropian.

Së fundmi, për qytetarët si përfitues të shërbimeve, politika e propozuar zgjeron drejtpërdrejt aksesin në një gamë më të gjerë profesionistësh të kualifikuar me shtrirje me te gjere territoriale, çka pritet të përmirësojë cilësinë e shërbimeve falë rritjes së konkurrencës. Një përfitim i tërthortë është edhe rritja e pritshme e të ardhurave, si rezultat i ndikimeve pozitive në tregun e punës dhe aktivitetet tregtare.

Gjithashtu, përshtatja e kërkesave për formimin në profesionet sektoriale dhe zbatimi i Direktivës (BE) 2018/958 pritet të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë dhe besueshmërisë së shërbimeve të ofruara.

Megjithëse standardet më të larta profesionale mund të sjellin një rritje të lehtë të çmimeve, kjo pritet të balancohet nga përfitimet më të gjera që lidhen me ofrimin e shërbimeve më cilësore, rritjen e besimit të qytetarëve dhe vlerën e shtuar që ata do të marrin në këmbim.

Me implementimin e politikës së propozuar, efektet si rezultat i prezantimit të standardeve të reja për rregullimin e profesioneve dhe njohjen e kualifikimeve profesionale do të jenë më të zbutura, për shkak se do të koordinohen nga një akt ligjor me efekt horizontal që do të mundësojë përafrimin tërësor të legjislacionit vendas me Direktivat në fjalë në mënyrë të organizuar dhe të përshkallëzuar.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Nëpërmjet hartimit të një ligji me efekt horizontal që përafron *acquis communautaire* në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale, do të bëhet i mundur adresimi i problematikave duke hedhur themelet për unifikimin dhe standardizimin e plotë të parashikimeve vendase për profesionet e rregulluara dhe njohjen e kualifikimeve profesionale.

Qeveria ka parashikuar se përafrimi i plotë i legjislacionit vendas me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 për testin e proporcionalitetit do të bëhet brenda vitit 2025, dhe kjo është një nder arsyet për të cilat, hartimi i një akti të vetëm të

përafruar plotësisht me të dyja Direktivat paraqitet më i volitshëm për realizimin e këtij objekti brenda afateve të parashikuara.

Ky opsion paraqet një qasje më efikase si në hartimin ashtu edhe në zbatimin e reformës, duke reduktuar kostot administrative dhe duke garantuar një shkallë të lartë koherence dhe harmonizimi të legjislacionit kombëtar me të drejtën e Bashkimit Evropian.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në milionë lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

[Analiza kuantitative për t'u plotësuar në një fazë të dytë.]

Viti <u>1</u>	Viti <u>2</u>	Viti <u>3</u>
-	-	-

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

kalon nga afati për zbatimin e vendimit të Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme.”.

[për plotësim pas procesit të konsultimit]

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi? (jo më shumë se 5 rreshta)

Duke marrë parasysh efektin horizontal të nismës së propozuar, zbatimi i saj kërkon përfshirjen e të gjitha ministrive të linjës dhe institucioneve të varësisë që mbikëqyrin profesionet e rregulluara, sipas fushave përkatëse të veprimit. Zbatimi dhe monitorimi do të mbikëqyren nga Ministria e Arsimit. Institucionet e tjera përgjegjëse për të siguruar që ligji të zbatohet në mënyrë të plotë dhe efektive, duke mbuluar të gjitha profesionet e rregulluara, si janë identifikuar në procesin e *screening*, janë:

- Ministria e Financave
- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit
- Ministria e Mjedisit
- Dhoma Kombëtare e Zejtarisë
- Urdhri i Veterinerëve
- Urdhri i Mjekëve
- Urdhri i Infermierëve
- Urdhri i Farmacistëve

- Urdhri i Stomatologëve
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë

Ndryshimi dhe përshtatja e akteve nënligjore pas miratimit të këtij ligji do të realizohet në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet përgjegjëse, të cilat luajnë një rol kyç në zbatimin e ligjit që rregullon njohjen e kualifikimeve profesionale dhe vlerësimin e proporcionalitetit. **Raportimi mbi zbatimin e ligjit duhet të jetë periodik, në një interval të vlerësuar si i arsyeshëm e të domosdoshëm dhe të rakorduar me Komisionin Evropian**, dhe do të përfshijë të dhëna mbi tregues kyç të performancës, përfshirë: numri i aplikimeve për njohje, koha mesatare e shqyrtimit dhe numri i ankesave të paraqitura. Gjithashtu, ndërveprimi institucional do të mbështetet në mënyrë të strukturuar përmes përdorimit të sistemit IMI (Internal Market Information System), i cili do të shërbejë si platformë për shkëmbimin e informacionit, monitorimin ndërinstitutional dhe sigurimin e transparencës në proces..

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

- **Rëndësia e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit.**

Me qëllim të garantimit të së drejtës së vendosjes dhe lirisë për ofrimin e shërbimeve, të cilat, në përputhje me parashikimet e Traktatit për Funksimin e Bashkimit Evropian (“TFBE”)³, qëndrojnë në themel të funksionimit të tregut të përbashkët, *acquis communautaire* harmonizon rregullat për profesionet e rregulluara, duke ndihmuar në njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale mes vendeve anëtare.

Ky regjim i siguron individëve të kualifikuar në një profesion të rregulluar në një shtet anëtar (shteti anëtar i origjinës), të kenë të drejtën të hyjnë dhe të praktikojnë këtë profesion në një shtet tjetër anëtar (shteti anëtar pritës).

Direktiva 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale unifikoi një sërë rregullash të përfshira në mënyrë të shpërndarë në disa Direktiva të BE-së sa i përket njohjes së kualifikimeve profesionale.

Sistemi i njohjes së kualifikimeve profesionale në Bashkimin Evropian, siç parashikohet nga Direktiva 2005/36/KE, është ndërtuar mbi një strukturë të ndarë sipas formave të ushtrimit të profesionit dhe llojit të kualifikimit.

Së pari, në rastet kur një profesionist dëshiron të ofrojë shërbime në mënyrë **të përkohshme ose të rastësishme** në një shtet tjetër anëtar pa u vendosur atje, zbatohen rregullat e **Titullit II**, që garantojnë të drejtën për lëvizje të lirë me një regjim të lehtësuar, duke përfshirë në disa raste një njoftim paraprak, veçanërisht për profesionet që lidhen me shëndetin dhe sigurinë publike.

Përkundrazi, kur qëllimi është **vendosja e përhershme** në një shtet tjetër për të ushtruar një profesion të rregulluar, zbatohen dispozitat e **Titullit III**, që përfshijnë tre mekanizma njohjeje: sistemin e përgjithshëm për shumicën e profesioneve, sistemin e **njohjes automatike (automatic recognition)** për profesionet sektoriale (si mjekët, infermierët, dentistët, veterinerët, farmacistët dhe arkitektët), dhe rregullat për **të drejtat e fituara (acquired rights)**, të cilat garantojnë ushtrimin e profesionit edhe kur profesionistët nuk plotësojnë plotësisht kriteret aktuale, por kanë përvojë të provuar.

³ Veçanërisht nenet 56 dhe 59 të TFBE.

Së fundi, **Titulli IV** i Direktivës parashikon përdorimin e **Kartës Profesionale Evropiane (EPC)** – një procedurë elektronike e thjeshtuar për njohjen e kualifikimeve, që përmes sistemit IMI lehtëson shkëmbimin e të dhënave ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe përshpejton vendimmarrjen për disa profesione të përzgjedhura.

Ky kuadër legjislativ reflekton rolin e dyfishtë të Shqipërisë gjatë dhe pas anëtarësimit në BE, si **shtet i origjinës**, që siguron standarde të njohura ndërkombëtarisht për profesionistët e saj, dhe si **shtet pritës**, që zbaton të njëjtat rregulla për profesionistët e vendeve të tjera anëtare, duke garantuar njohje të ndërsjellë dhe lëvizje të lirë në përputhje me *acquis communautaire*.

Ajo është e zbatueshme për të gjithë shtetasit e BE-së që kanë fituar kualifikimet profesionale në një shtet anëtar dhe që synojnë të ushtrojnë profesionin e rregulluar në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai i origjinës.

Në mënyrë specifike, Direktiva 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale përcakton procedurat që shtetet anëtare përdorin për të njohur kualifikimet e përfituara në shtetet e tjera anëtare, me qëllim ushtrimin e profesioneve të rregulluara në territorin e tyre. Kjo Direktivë gjithashtu përcakton mekanizmat e miratuar nga shtetet anëtare për njohjen e kualifikimeve profesionale të fituara jashtë territorit të tyre.

Kur kualifikimet profesionale janë përfitur jashtë Bashkimit Evropian, njohja e tyre për ushtrimin e një profesioni të rregulluar brenda një Shteti Anëtar rregullohet nga rregullat e përcaktuara në kuadrin ligjor vendas të atij shteti, në përputhje me parashikimet e Direktivës 2005/36/KE. Kjo vlen vetëm në mungesë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe për njohjen e ndërsjellë, pasi Direktiva 2005/36/KE parashikon një fleksibilitet të kufizuar për shtetet anëtare në këtë drejtim, duke u lënë atyre një diskrecion të kufizuar për mënyrën e vlerësimit të kualifikimeve të fituara jashtë BE-së në mungesë të harmonizimit të ndërsjellë.

Zbatimi i Direktivës mbështetet gjithashtu në mekanizma praktikë si Karta Profesionale Evropiane (EPC)-procedura elektronike e thjeshtuar- dhe Sistemi i Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI) së bashku me shumëgjuhësh komunikim administrativ mes vendeve të BE, të cilët lehtësojnë transparencën dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve anëtare, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit dhe besueshmërisë së procesit të njohjes së kualifikimeve..

Në funksion të rritjes së efektivitetit të zbatimit të Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale, Direktiva (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit synon të njësojë rregullat e zbatimit të këtij testi në rastin e miratimit të rregullimeve të reja për profesionet nga shtetet anëtare të BE-së. Kjo Direktivë zbatohet vetëm për rregullat e reja ose për ndryshimet thelbësore të rregullave ekzistuese që kufizojnë hyrjen ose ushtrimin e profesioneve të rregulluara, dhe kërkon që vlerësimet e proporcionalitetit të jenë të dokumentuara në mënyrë transparente dhe të bazuara në prova objektive.

të çdo mase ligjore, rregullatore apo administrative që prek qasjen apo ushtrimin e një profesioni të rregulluar. Kjo nënkupton që vlerësimi i proporcionalitetit duhet të jetë pjesë e domosdoshme e procesit rregullator dhe të përfundojë përpara se masa të miratohet.

Shtetet anëtare mbajnë gjithashtu detyrimin e transparencës, përfshirë raportimin mbi profesionet e rregulluara dhe justifikimin e çdo kërkesë të re përmes një analize të dokumentuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 59 të Direktivës 2005/36/KE dhe nenin 4 të Direktivës 2018/958.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për ofrimin e shërbimeve në jetësimin e idesë së tregut të përbashkët, rregullat që vendosin shtetet anëtare për ndjekjen e profesioneve në territorin e tyre në mungesë të parashikimeve njësuese të *acquis*, nuk duhet të përbëjnë një pengesë të pajustifikuar ose joproporcionale për ushtrimin e këtyre të drejtave themelore.⁴

⁴ Recitalet 1, 2 dhe 3 të Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit.

Përpara miratimit të dispozitave të reja rregulluese, ose ndryshimit të rregullave ekzistuese që kufizojnë ndjekjen e profesioneve, shtetet anëtare kanë barrën e provës në lidhje me proporcionalitetin e masave të reja që propozojnë.⁵

Testi i proporcionalitetit, si një parim i përgjithshëm i së drejtës së BE-së, kërkon që çdo masë e propozuar të jetë:

- Jo diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi bazën e shtetësisë apo vendbanimit;
- E justifikuar nga arsye madhore me interes të përgjithshëm;
- E përshtatshme për të arritur objektivin legjitim të ndjekur; dhe
- Të mos shkojë përtej asaj që është e domosdoshme për arritjen e objektivit.

Vlerësimi i proporcionalitetit të masës garantohej duke kryer një analizë gjithëpërfshirëse të përshtatshmërisë së saj. Me qëllim unifikimin e metodologjisë së ndjekur nga shtetet anëtare për kryerjen e këtij vlerësimi, Direktiva (BE) 2018/958 përcakton një kuadër analitik të unifikuar në nivel BE për zbatimin e testit të proporcionalitetit gjatë hartimit të rregullave të reja për ushtrimin e profesioneve, në përputhje me *acquis communautaire*.

➤ Konteksti i ndërhyrjes në kuadrin ligjor vendas

Ky propozim paraqitet në kuadër të angazhimeve të parashikuara në nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, botuar me Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 87, datë 14.08.2006 (këtu e në vijim referuar si “MSA”).

Neni 70 i MSA përcakton angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të përafruar legjislacionin vendas me legjislacionin e BE-së. Pika 1 e tij përcakton se “*Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me acquis e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.*”

Rrjedhimisht, anëtarësimi në BE dhe integrimi i plotë evropian mbeten ndër objektivat politike dhe strategjike më të rëndësishme të vendit. Procesi i anëtarësimit në BE përfshin, ndër të tjera, edhe përafrimin dhe harmonizimin e plotë të sistemeve ligjore, ekonomike dhe institucionale të vendit me qëllim integrimin e plotë me tregun e përbashkët të BE-së.⁶

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (“SKZHIE”) 2022-2030, si dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë, përcakton se vizioni i Republikës së Shqipërisë për periudhën 2022–2030 fokusohet drejt përafrimit të plotë të kuadrit ligjor e institucional me qëllim arritjen e standardeve që i përgjigjen anëtarësimit në BE.⁷

Gjatë procesit të shqyrtimit të kuadrit ligjor ekzistues nga pikëpamja e nivelit të përafrimit me kapitujt e *acquis communautaire* (“**screening**”) dhe konkretisht me kapitullin 3, në linjë me parashikimet e

⁵ Recitalet 12 dhe 13 të Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit.

⁶ PKIE 2024-2026, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 11.1.2024.

⁷ SKZHIE 2022-2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 22.2.2023.

metodologjisë së rishikuar të zgjerimit të Komisionit Evropian (“**Metodologjia e Zgjerimit**”)⁸, si dhe bazuar në gjetjet e raporteve të progresit për Shqipërinë të Komisionit Evropian,⁹ është evidentuar nevoja për përafrimin e plotë të kuadrit ligjor vendas me *acquis communautaire* në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale.

Në këtë kuadër, është theksuar qartësisht nevoja për përafrim të mëtijshëm si me Direktivën 2005/36/KE, ashtu edhe me Direktivën (BE) 2018/958, si një kërkesë e shprehur dhe e përsëritur e Komisionit Evropian në Raportin e Progresit 2024 për Shqipërinë. E njëjta kërkesë është pasqyruar edhe në Pozicionin e Përbashkët të Bashkimit Evropian për mbylljen e negociatave të anëtarësimit për Kapitullin 3 – miratuar më 11 prill 2025 në të cilin përafrimi i plotë me të dy Direktivat përmendet si një parakusht për përmbylljen e këtij kapitulli.

Njëkohësisht, kjo domosdoshmëri është reflektuar edhe në Pozicionin Negociues të Shqipërisë për konkretisht për Kapitullin 3, i cili parashikon realizimin e përafrimit të plotë rregullator me Direktivën 2005/36/KE dhe Direktivën (BE) 2018/958 brenda vitit 2027, si dhe sigurimin e gatishmërisë së plotë institucionale dhe administrative për zbatimin e tyre deri në vitin 2030 – datë që përkon me objektivin e Shqipërisë për anëtarësim në BE.

Përafrimi i kuadrit vendas me parashikimet e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 për testin e proporcionalitetit, përbën edhe një nga objektivat dhe angazhimet e ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në kuadër të Planit të Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal 2021-2024.

Konkretisht, në nivel rajonal, Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve profesionale të mjekëve, stomatologëve dhe arkitektëve në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 27.1.2023, si dhe marrëveshjen për njohjen e kualifikimeve profesionale të infermierëve, mjekëve veterinarë, farmacistëve dhe mamive në kontekstin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, nënshkruar nga përfaqësues të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, ratifikuar me ligjin nr. 24/2024 “Për ratifikimin e marrëveshjes për njohjen e kualifikimeve profesionale të infermierëve, veterinerëve, farmacistëve dhe mamive në kontekstin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Qendrore” (këtu e në vijim referuar bashkërisht si “**marrëveshjet rajonale për njohjen e kualifikimeve profesionale në profesionet sektoriale**”).

Në vijim të detyrimeve të ndërmarra nga qeveria shqiptare gjatë takimeve bilaterale të procesit *screening* për përafrimin e legjislacionit shqiptar brenda vitit 2023 me kushtet minimale të formimit për shtatë profesione të rregulluara (mjek, infermier, stomatolog, kirurg veterinar, mami, farmacist dhe arkitekt), të referuara këtu e në vijim si “profesionet sektoriale”, në përputhje me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale, Këshilli i Ministrave miratoi në dhjetor të vitit 2023 Vendimin nr. 823, datë 28.12.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar”.

Rrjedhimisht, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar (“**VKM nr. 41/2018**”),¹⁰ Shqipëria ka përafruar pjesërisht dispozitat e Titullit III, Kapitulli III të Direktivës 2005/36/EC për njohjen

⁸ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0057>.

⁹ Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Shqipërinë 2023: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en.

¹⁰ Teksti i përditësuar i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, gjendet në: <https://qbz.gov.al/share/lrxcpPfQTWpLFWp5IDZ8Lw>.

e kualifikimeve profesionale. Këto dispozita përcaktojnë elementet minimale që duhet të përmbajnë programet e studimit për profesionet sektoriale, me qëllim unifikimin e këtyre programeve në nivel BE dhe zbatimin e sistemit automatik të njohjes të kualifikimeve profesionale. Duke përcaktuar kushtet minimale të formimit për profesionet sektoriale, janë hedhur themelet për garantimin e një niveli të barabartë të përgatitjes bazë profesionale për profesionistët shqiptarë, duke iu mundësuar atyre të jenë konkurrues në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar. Kjo pritet të ndihmojë edhe në rritjen e besueshmërisë së shërbimeve profesionale të ofruara në vend, duke i dhënë përfituesve të shërbimit dhe partnerëve të biznesit një siguri të shtuar në cilësinë dhe aftësitë e profesionistëve. Ky përafrim është i kufizuar në aspektin e kushteve të formimit, por nuk mbulon ende mekanizmat e njohjes automatike, përfshirë funksionin e autoriteteve kompetente, procedurat, termat dhe dispozitat tranzitore sipas nenit 21–49 të Direktivës.

Nisma e propozuar ka për qëllim të rregullojë detyrimet që i takojnë Shqipërisë dhe autoriteteve të saj kompetente në cilësinë e vendit të origjinës, në kuptim të Titullit III, Kapitulli III i Direktivës 2005/36/KE, lidhur me lëshimin e dokumentacionit për njohjen e kualifikimeve në shtetet e tjera anëtare.

Duhet theksuar se përafrimi me kushtet minimale të trajnimit për specializimet mjekësore dhe ato stomatologjike po adresohet veçmas përmes një akti nënligjor për ndryshimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si pjesë e procesit të përafrimit të plote me Direktivën. 2005/36/KE.

Rrjedhimisht, pavarësisht hapave të ndërmarra deri më tani lidhur me përafrimin e kuadrit ligjor vendas me *acquis communautaire*, sistemet e njohjes së kualifikimeve profesionale sipas Direktivës 2005/36/KE dhe rregullat për zbatimin e testit të proporcionalitetit në rast të miratimit të rregullimeve të reja që kufizojnë ndjekjen e profesioneve sipas parashikimeve të Direktivës (BE) 2018/958, mbeten të pa transpozuar në legjislacionin shqiptar. Sipas vlerësimit të Komisionit Evropian mbi zbatimin e Direktivës (BE) 2018/958 një numër i konsiderueshëm shtetesh anëtare vijnë të hasin vështirësi në zbatimin korrekt të testit të proporcionalitetit, duke përfshirë mungesën e analizave objektive dhe të dokumentuara për justifikimin e barrierave rregullatore. Ky konstatim thekson nevojën për ndërtimin e një kuadri të qartë, gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar për zbatimin efektiv të kësaj Direktive edhe në Shqipëri, në përputhje me parimet dhe standardet e *acquis communautaire*.

Transpozimi dhe zbatimi i Direktivës 2005/36/KE dhe i Direktivës (BE) 2018/958 kërkon gjithashtu ndërhyrje strukturore në nivel institucional, përfshirë rishikimin dhe rishpërndarjen e kompetencave ndërmjet autoriteteve rregullatore, me një theks të veçantë mbi forcimin e rolit të Ministrisë së Arsimit si organ koordinues. Njëkohësisht, kërkohet ndërtimi i kapaciteteve administrative dhe teknike për përdorimin efektiv të mjeteve elektronikë si Sistemi i Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI) dhe Karta Profesionale Evropiane (EPC), në përputhje me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

➤ Natyra, shkaqet, dhe shtrirja e problemit

Natyra e problemit ka karakter legjislativ dhe institucional, që lidhet me nevojën për të përafruar kuadrin ligjor vendas me parashikimet e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 për testin e proporcionalitetit.

Shkaqet e problemit rregullator mund të ndahen në dy kategori kryesore:

- Shkaqet e brendshme, që lidhen kryesisht me mungesën e bashkërendimit ndërinstitucional, fragmentimin e kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse, mungesën e burimeve teknike dhe njerëzore për zbatimin e kërkesave të *acquis*-it, si dhe kapacitetet e pamjaftueshme për përdorimin e instrumenteve elektronikë si IMI dhe EPC.
- Shkaqet e jashtme, që burojnë nga dinamika e vetë *acquis*, përfshirë ndryshimet e vazhdueshme në standardet e BE-së për profesionet sektoriale, mekanizmat e njohjes automatike dhe përditësimet periodike të kriterëve për testin e proporcionalitetit, të cilat kërkojnë përshtatje të vazhdueshme të legjislacionit vendas.

Aktualisht, ligji nr. 10 171, datë 22.10.2009 “*Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar (“Ligji për profesionet e rregulluara”), është i përafruar vetëm pjesërisht me disa nga nocionet bazë të Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale (p.sh., përkufizimet e termave “profesion i rregulluar”, “kualifikim profesional”, “praktikë profesionale”, etj.).

Ky ligj nuk përmban dispozita të posaçme lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve profesionale, dhe as mekanizma për vlerësimin *ex ante* të rregullimeve që kufizojnë ushtrimin e profesioneve të rregulluara. Fokusi i tij qëndron në përcaktimin e kushteve të përgjithshme për ushtrimin e profesioneve të rregulluara, përfshirë licencimin dhe rregullimin e kompetencave institucionale, por pa ndërtuar një regjim të harmonizuar njohjeje të kualifikimeve në përputhje me *acquis*.

Gjithashtu, VKM nr. 952, datë 25.07.2012, “*Për procedurat dhe kriteret e njohjes së profesioneve të rregulluara*”, parashikon përjashtime nga detyrimi për provim shtetëror për personat e kualifikuar në vende të BE-së. Megjithatë, ky përjashtim nuk ndërtohet mbi një sistem të përafruar me kërkesat e Direktivës 2005/36/KE dhe nuk reflekton mekanizmat procedurale dhe institucionale të saj. Në praktikë, njohja vazhdon të rregullohet në mënyrë të fragmentuar përmes legjislacionit sektorial, pa standarde të përbashkëta dhe jashtë kornizës së përcaktuar nga Direktiva.

Aktualisht mungon një akt ligjor apo nënligjor që të vendosë detyrimin për kryerjen e vlerësimeve të proporcionalitetit *ex ante*, në përputhje me kërkesat e Direktivës (BE) 2018/958. Kjo sjell një boshllëk të rëndësishëm rregullator dhe institucional për sa i përket garantimit të një procesi transparent, të dokumentuar dhe të justifikuar për miratimin e rregullave të reja për profesionet e rregulluara.

Nga ana tjetër, pas përfundimit të procesit *screening* si pjesë e angazhimeve të prejardhura nga procesi i negociatave për anëtarësim në BE, janë evidentuar një sërë aktesh ligjore e nënligjore sektoriale për profesionet e rregulluara që nuk janë në përputhje me parashikimet e *acquis communautaire* në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale.

Konkretisht, Grupi Ndër-Institucional i Punës (“GNP”) për Kapitullin 3, i udhëhequr nga MA, ka përfunduar në nëntor të vitit 2022 hartimin e një udhërrëfyese gjithëpërfshirës për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis communautaire* në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale (“**Udhërrëfyese për përafrimin me *acquis* për njohjen e kualifikimeve profesionale**” ose “**Udhërrëfyese**”).¹¹

Udhërrëfyese përmban një analizë të detajuar të përputhshmërisë së kuadrit rregullator dhe institucional vendas me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 për testin e proporcionalitetit, si dhe me *acquis* specifik për disa profesione të rregulluara.

¹¹ Udhërrëfyese “*Roadmap on harmonisation with the Mutual Recognition of Professional Qualifications Acquis (Chapter 3)*”, është përgatitur me mbështetjen e bashkëpunimit gjerman (GIZ) në kuadër të projektit “Support to accession negotiations in economic chapters of the *acquis*” (SANECA) dhe ICON Institut GmbH, nëntor 2022.

Në përfundim të analizës gjithëpërfshirëse të kryer në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit, janë identifikuar më shumë se 300 profesione të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, duke evidentuar po ashtu edhe mospërputhjet e legjislacionit përkatës me parashikimet e *acquis communautaire* në këtë fushë.

Mostranspozimi i plotë i sistemit të njohjes së kualifikimeve, përfshirë si skemën e njohjes automatike për profesionet sektoriale ashtu edhe sistemin e përgjithshëm, pengon efektivitetin e qasjes së profesionistëve të huaj në tregun shqiptar dhe dëmton bashkëpunimin administrativ ndërmjet autoriteteve të shteteve anëtare. Kjo sjell barriera të panevojshme për lëvizjen e lirë të profesionistëve, mungesë transparence për aplikantët dhe një vendimmarrje të paunifikuar nga ana e autoriteteve kompetente shqiptare, duke cenuar parimet themelore të Direktivës 2005/36/KE.

Mungesa e një kuadri të plotë dhe të harmonizuar ligjor jo vetëm që ndikon në sigurinë juridike të profesionistëve të rregulluar, por edhe dëmton klimën e përgjithshme të besimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional me vendet e BE-së, në kundërshtim me pritshmërinë e përafrimit.

Gjithashtu, përmes ndryshimeve të miratuara në dhjetor 2023 në VKM nr. 41/2018, Shqipëria ka bërë një hap të rëndësishëm drejt përafrimit me kërkesat minimale të Direktivës 2005/36/KE për programet e studimit të profesioneve sektoriale. Kjo ndërhyrje synon harmonizimin e kurrikulave vendase me standardet e BE-së, duke krijuar parakushtet e nevojshme për funksionimin e sistemit të njohjes automatike për profesionistët shqiptarë që synojnë të ushtrojnë profesionin në një vend të BE-së, ZEE-së apo Zvicrës.

Megjithatë, kjo ndërhyrje nuk mjafton për të siguruar përafrimin e plotë me Direktivën 2005/36/KE. Ndërhyrja e planifikuar në kuadër të këtij RIA do të duhet të përmbushë më tej harmonizimin me kushtet minimale të formimit, përfshirë ato që lidhen me specializimet mjekësore dhe stomatologjike (aktualisht në proces përmes ndryshimit të Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë), si dhe të krijojë bazën ligjore për lëshimin e dokumentacionit standard të kërkuar nga Direktiva.

Kjo përfshin lëshimin e certifikatave të kualifikimeve dhe dëshmimeve për të drejtat e fituara, të cilat janë të domosdoshme për profesionistët vendas që dëshirojnë të ushtrojnë profesionin në vendet e BE-së, në përputhje me kapitullin III të Direktivës 2005/36/KE dhe kërkesat për dokumentacion nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse.

Megjithatë, kuadri ligjor vendas ende nuk përfshin sistemet e njohjes së parashikuara në Direktivën 2005/36/KE, dhe as nuk pasqyron në mënyrë të plotë rregullat e detajuara për zbatimin e testit të proporcionalitetit, siç përcaktohet në Direktivën (BE) 2018/958.

Është e rëndësishme të theksohet se moszbatimi i një metodologjie të unifikuar dhe të dokumentuar për testin e proporcionalitetit, siç kërkohet nga Direktiva 2018/958/BE, rrezikon të çojë në miratimin e masave të reja rregullatore pa një justifikim të mjaftueshëm objektiv apo proporcional. Kjo mund të sjellë vendosjen e barrierave shtesë dhe të panevojshme për profesionistët, duke cenuar parimin e proporcionalitetit si një shtyllë themelore e së drejtës së Bashkimit Evropian.

Sipas vlerësimit të Komisionit Evropian, edhe shumë shtete anëtare që kanë transpozuar pjesërisht këtë Direktivë nuk kanë arritur të përcaktojnë një kuadër formal dhe funksional për zbatimin e testit në aktet legjislative themelore, duke ndikuar negativisht në transparencën, parashikueshmërinë dhe besimin e palëve të interesuara në procesin rregullator. Ky risk është edhe më i theksuar në kontekstin shqiptar, në mungesë të një akti ligjor që të përfshijë në mënyrë të detajuar metodologjinë e vlerësimit *ex ante* për rregullat që kufizojnë ushtrimin e profesioneve të rregulluara.

➤ Grupet e prekura nga problemi

Grupet e prekura janë qeveria dhe autoritetet publike përgjegjëse për rregullimin e hyrjes në profesion dhe ushtrimin e tij (rregullatorët), profesionistët, urdhrat profesionalë, IAL-të, studentët dhe profesionistët e kualifikuar të tashëm e të ardhshëm, punëdhënësit/bizneset vendase, si edhe qytetarët si përfitues shërbimesh.

Qeveria dhe autoritetet publike:

Qeveria ndikohet drejtpërdrejt nga mungesa e përafrimit të plotë të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire*, veçanërisht për sa i përket njohjes së kualifikimeve profesionale dhe testit të proporcionalitetit. Kjo krijon nevojën për ndërhyrje të menjëhershme për plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, si dhe cenon objektivat afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit ekonomik dhe integritit evropian. Duke marrë parasysh angazhimet e Republikës së Shqipërisë për përafrimin me *acquis-in* si një nga elementët kyç të përgatitjes për anëtarësim në BE, çdo vonesë në transpozimin dhe zbatimin e tij ndikon drejtpërdrejt në realizimin e objektivave strategjikë të shtetit shqiptar, të përfshira në programin qeverisës dhe dokumentet afatgjata të integritit.

Për më tepër, mungesa e harmonizimit të plotë me sistemet dhe mekanizmat e BE-së përbën një risk strategjik për Shqipërinë, pasi rrezikon gatishmërinë e vendit për të përmbushur kërkesat për mbylljen e Kapitullit 3 të negociatave të anëtarësimit. Kjo situatë mund të ndikojë negativisht edhe në mundësinë për të përfituar nga mekanizmat e përkohshëm të Bashkimit Evropian që mundësojnë njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, duke kufizuar për shembull qasjen në integrimin e përsheptuar në tregun e përbashkët të shërbimeve profesionale.

Profesionistët:

Duke qenë se ligji për profesionet e rregulluara nuk përafron sistemet e njohjes së kualifikimeve profesionale sipas Direktivës 2005/36/KE, si edhe duke marrë parasysh se parashikimet e ligjeve sektoriale që rregullojnë profesione të caktuara nuk janë në linjë me *acquis*, profesionistët e kualifikuar në vendet e BE-së që duan të ushtrorjnë profesionin e tyre në Shqipëri mund të hasin pengesa të konsiderueshme për njohjen e kualifikimeve të tyre profesionale për shkak të barrierave rregulluese.

Gjithashtu, pavarësisht se nëpërmjet VKM nr. 41/2018 janë përafruar pjesërisht kushtet minimale të formimit që duhet të përmbajnë programet e studimit për profesionet sektoriale, vonesat në përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me Titullin III, Kapitulli III të Direktivës 2005/36/KE, ndikojnë edhe në zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në kuadër të marrëveshjeve rajonale për njohjen e kualifikimeve profesionale në profesionet sektoriale, duke kufizuar mundësinë e lëvizjes së lirë të profesionistëve brenda vendeve të rajonit.

Urdhrrat profesionalë:

Vonesat në transpozimin e parashikimeve të Direktivës 2005/36/KE e rrjedhimisht edhe në zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në kuadër të marrëveshjeve rajonale për njohjen e kualifikimeve profesionale në profesionet sektoriale, pasjellin edhe vonesa në përshtatjen dhe linjëzimin e veprimtarive të urdhrave profesionalë duke pasur në fokus heqjen e pengesave për ushtrimin e profesioneve të rregulluara në nivel rajonal dhe evropian. Përkatesisht nga analiza e Komisionit Evropian në dokumentin punues, (SWD (79) final) identifikon risqet si vijon:

1. Fragmentimi rregullator dhe mungesa e unifikimit të procedurave

Në mungesë të një kuadri ligjor të harmonizuar, urdhrat profesionalë veprojnë mbi baza të fragmentuara dhe jo të standardizuara. Ata shpesh zhvillojnë procedura të veçanta për njohjen e kualifikimeve ose për

aksesin në profesion, të cilat nuk janë të harmonizuara me mekanizmat evropianë si IMI apo EPC. Kjo krijon pasiguri ligjore dhe pamundëson lëvizjen reale të profesionistëve vendas dhe të huaj.

2. Rreziku i interpretimit arbitrar dhe mungesës së transparencës

Për shkak të mungesës së udhëzimeve të qarta ligjore dhe transpozimit të standardeve të BE-së, organet rregullatore mund të marrin vendime mbi bazën e kritereve jo të dokumentuara mirë, duke rritur rrezikun e subjektivitetit dhe diskriminimit. Kjo është veçanërisht e dukshme në rastet kur urdhrat profesionalë përballen me kërkesa për njohjen e kualifikimeve nga vende të BE-së dhe nuk kanë udhëzime përkatëse ligjore për të zbatuar parimin e njohjes së ndërsjellë.

3. Ndikimi në integrimin evropian dhe bashkëpunimin ndërinstitutional

Mosfeksionimi i mekanizmave si IMI nga ana e urdhrave profesionalë, për shkak të mungesës së rregullimit të rolit të tyre brenda sistemit të njohjes, e pengon bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të BE-së. Kjo i penalizon jo vetëm profesionistët që kërkojnë të punojnë jashtë, por edhe vetë institucionet që nuk janë në gjendje të shkëmbejnë në mënyrë efektive informacionin rregullator.

4. Pamundësia për të marrë pjesë në rrjetet evropiane të vendimmarrjes

Mungesa e transpozimit të plotë kufizon përfshirjen aktive të rregullatorëve shqiptarë në rrjetet evropiane të bashkëpunimit dhe vendimmarrjes për politikën profesionale – siç janë grupet e ekspertëve që zhvillojnë standardet për EPC, IMI dhe për njohjen automatike të kualifikimeve sektoriale.

Në mungesë të një ligji të unifikuar dhe të transpozimit të plotë të Direktivave 2005/36/EC dhe 2018/958, urdhrat profesionalë dhe rregullatorët mbeten pengesë, jo mjet, për integrimin e Shqipërisë në sistemin e njohjes së kualifikimeve të BE-së. Kjo ka pasoja të drejtpërdrejta për mobilitetin profesional, përgatitjen për përdorimin e IMI dhe EPC, si dhe për aftësinë e Shqipërisë për të përfituar nga masat e përkohshme të njohjes reciproke gjatë periudhës para-aderimit.

Institucionet e arsimit të lartë (“IAL”):

IAL-të ende nuk garantojnë programe formimi të krahasueshme me kushtet minimale të formimit në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe të barasvlershme me programet e tjera të studimit, duke u bërë më pak tërheqëse për studentët dhe më pak dobiprurëse për tregun.

Implementimi i ndryshimeve të fundit të VKM nr. 41/2018 si edhe transpozimi i plotë i aspekteve të tjera rregullatorë të Direktivës 2005/36/KE mundëson standardizimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL me programet e studimit në nivel rajonal dhe evropian.

Studentët dhe profesionistët e kualifikuar të ardhshëm:

Mospërputhjet e kuadrit ligjor vendas në lidhje me programet e studimit për profesionet sektoriale – të cilat parashikohen të përshtaten me kërkesat e VKM nr. 41/2018 brenda vitit akademik 2027–2028 – si edhe mospërputhja e kritereve që vendos legjislacioni vendas me ato të *acquis communautaire* në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale, mund të përbëjnë faktorë të rëndësishëm që kontribuojnë në largimin e studentëve dhe profesionistëve të rinj jashtë vendit. Kjo tendencë përshpejton fenomenin e “largimit të trurit” (brain drain), duke ndikuar drejtpërdrejt në kapacitetin afatgjatë të vendit për të ndërtuar një treg të qëndrueshëm të punës dhe për të ruajtur kapitalin njerëzor të kualifikuar.

Sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian, mungesa e standardeve të njësura në formim dhe njohje të kualifikimeve rrit pasigurinë për njohjen e tyre në tregjet ndërkombëtare dhe ul ndjeshëm motivimin për të ndërtuar një karrierë profesionale në vendin e origjinës. Kjo pasiguri jo vetëm që ndikon në emigrimin profesional, por gjithashtu dobëson besimin publik në funksionimin e sistemeve kombëtare të arsimit dhe rregullimit profesional.

Punëdhënësit/bizneset vendase:

Punëdhënësit hasin gjithmonë e më tepër vështirësi në gjetjen e profesionistëve të kualifikuar. Barrierat rregulluese për lëvizjen e lirë të profesionistëve brenda rajonit, dhe mungesa e standardizimit të procedurave për njohjen e kualifikimeve profesionale të fituara jashtë Shqipërisë, zvogëlon mundësitë për tërheqjen e profesionistëve të kualifikuar në Shqipëri, e rrjedhimisht edhe në mbarëvajtjen e qëndrueshme të aktivitetit tregtar të bizneseve vendase.

➤ Mundësia e trajtimit të problemit përmes politikave ndryshuese

Këto probleme mund të trajtohen vetëm përmes një ndryshimi të politikës në nivel legjislativ. Natyra e problematikave të identifikuar, përfshirë mospërputhjet strukturore në kuadrin ligjor aktual, fragmentarizimin e rregullimeve për njohjen e kualifikimeve, si dhe mungesën e një metodologjie të qartë për testin e proporcionalitetit – dikton nevojën për ndërhyrje të thellë dhe gjithëpërfshirëse në politikëbërje. Vetëm një instrument i tillë politikash, i mbështetur në legjislacionin përkatës, mund të garantojë trajtimin e problemeve të sipërcituara në përputhje me kërkesat e Direktives 2005/36/EC dhe të Direktivës (BE) 2018/958.

Në këtë kontekst, vlerësohet se asnjë nga aktet ekzistuese në kuadrin rregullator nuk është i përshtatshëm për transpozimin e plotë të këtyre Direktivave. Siç u analizua më sipër, ligji nr. 10 171/2009 i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse mbulojnë vetëm pjesërisht elemente të veçanta të Direktivave dhe nuk adresojnë në mënyrë të unifikuar dhe të integruar tërësinë e kërkesave rregullatore që burojnë prej tyre. Për këtë arsye, është vlerësuar e domosdoshme miratimi i një ligji të ri të posaçëm, i cili do të mundësojë një përafrim të plotë, të saktë dhe të qëndrueshëm të kuadrit ligjor shqiptar me *acquis communautaire* në këtë fushë.

Kjo qasje mbështetet gjithashtu në parashikimet 642, të faqes nr. 183, në Manualin për Hartimin e Legjislacionit, është parashikuar se “Si rregull sugjerohet që në rast se një akt parësor ndryshohet në më shumë se 50% në përmbajtjen e tij nga ndryshimet e mëvonshme, në vend të një akti ndryshues, duhet të miratohet një akt zëvendësimi”. Në rastin konkret, ndryshimet që nevojiten për të përputhur kuadrin ligjor vendas me kërkesat e dy Direktivave të sipërcituara tejkalojnë ndjeshëm këtë prag, gjë që përjashton mundësinë e ndërhyrjeve përmes ndryshimeve të pjesshme apo aktesh nënligjore. Prandaj, një ligj i ri përbën zgjidhjen e vetme të justifikuar dhe efektive.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Nevoja për ndërhyrje nga ana e qeverisë nuk lidhet vetëm me domosdoshmërinë për të përmbushur kërkesat teknike të përafrimit me *acquis communautaire*, por mbi të gjitha me angazhimet politike të ndërmarra nga Shqipëria në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Këto angazhime janë të formalizuara në dokumentet strategjike kombëtare si: (i) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 (SKZHI 2030), (ii) Plan i Kombëtar për Integrimin Evropian 2025–2027 (PKIE), dh (iii) Pozicioni Negociues i Shqipërisë për Kapitullin 3 – E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime (2025).

Përafrimi i plotë me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 për testin e proporcionalitetit, si dhe respektimi i marrëveshjeve rajonale për njohjen e

kualifikimeve në profesionet sektoriale, përbëjnë kusht teknik për mbylljen e Kapitullit 3 të negociatave, i cili parashikohet të përmbyllet brenda vitit 2027.

Mungesa e ndërhyrjes ligjore dhe institucionale rrezikon jo vetëm mbylljen në kohë të këtij kapitulli, por edhe ritmin e përgjithshëm të negociatave, duke vënë në pikëpyetje objektivin strategjik për anëtarësim të plotë të Shqipërisë në BE deri në vitin 2030.

Gjithashtu, nëpërmjet përafrimit të kuadrit ligjor vendas me Direktivën 2005/36/KE dhe Direktivën (BE) 2018/958 do të kontribuohet në standardizimin e sistemeve të njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale me rajonin dhe tregun evropian.

Përmes ndërhyrjes së saj, qeveria synon të trajtojë problemin e mungesës së përafrimit të legjislacionit me Direktivën e sipërcituar. Kjo ndërhyrje mbështet një nga objektivat kryesorë të qeverisë, siç është integrimi evropian. Një ndër aspektet kyçe të këtij procesi është përafrimi i legjislacionit të brendshëm me *acquis communitaire*.

Për rrjedhojë, kjo nismë politike synon të arrijë pajtueshmëri të plotë të legjislacionit kombëtar me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale, si dhe me Direktivën (BE) 2018/958 për testin e proporcionalitetit.

Sa i takon çështjes së objektivave që synon të adresojë ndërhyrja, përveç përafrimit rregullator, nevojitet të diferencohen qartë elementët ligjorë, institucionalë dhe procedurale, si më poshtë:

- Nga aspekti ligjor, ndërhyrja synon konsolidimin e kuadrit normativ në një akt të vetëm, gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar me *acquis-in*, duke përmirësuar ndjeshëm sigurinë juridike për autoritetet dhe profesionistët.
- Nga aspekti institucional, ndërhyrja synon të shmangë fragmentimin e kompetencave ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe rregullatorëve sektorialë, fenomen i identifikuar edhe nga Komisioni Evropian në vendet anëtare.
- Nga aspekti procedural ndërhyrja synon të krijojë një sistem të vetëm kombëtar, funksional si për Shqipërinë si vend origjine, ashtu edhe si vend pritës të profesionistëve, duke standardizuar procedurat e njohjes dhe vendimmarrjes për të gjitha kategoritë e kualifikimeve.

Ndërhyrja gjithashtu synon të sigurojë një qasje të unifikuar dhe të koordinuar në vlerësimin dhe rregullimin e profesioneve, duke reduktuar fragmentimin institucional dhe rreziqet për vendosjen e barrierave të pajustificuara për hyrjen në profesione.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat që synohen të arrihen përmes politikës së propozuar janë:

- Të përfundohet përafrimi i plotë i kuadrit ligjor kombëtar me Direktivën 2005/36/KE dhe Direktivën (BE) 2018/958 brenda tremujorit të katërt të vitit 2025, në përputhje me afatet e përcaktuara në PKIE 2024–2026 dhe angazhimet për Kapitullin 3 të negociatave të anëtarësimit.
- Të miratohet dhe vihet në zbatim një ligj i ri gjithëpërfshirës për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe testin e proporcionalitetit jo më vonë se viti 2030, duke zëvendësuar kuadrin aktual të fragmentuar dhe duke garantuar përputhje të plotë me *acquis-in* përkatës të BE-së.

- Të zbatohet testimi i proporcionalitetit për çdo rregullim të ri që prek profesionet e rregulluara duke filluar nga tremujori i katërt i 2030, bazuar në një metodologji të unifikuar të miratuar nga MA dhe rregullatorët sektorialë.
- Të ngrihet dhe funksionalizohet një njësi e posaçme brenda Ministrisë së Arsimit për ushtrimin e rolit të Koordinatorit Kombëtar të Profesioneve, me mandate të qarta dhe burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.
- Të trajnohen nëpunës civilë nga MA, rregullatorët sektorialë dhe institucionet përkatëse brenda vitit 2027, për zbatimin e testit të proporcionalitetit, procedurat e njohjes së kualifikimeve dhe përdorimin e platformave si IMI dhe EPC.
- Të hartohen dhe publikohen të gjitha aktet nënligjore zbatuese të ligjit të ri brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij, për të garantuar efektivitetin e kuadrit të ri ligjor.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

- **Opsioni 1** – Ndërhyrje të targetuara në aktet ligjore e nënligjore pjesë të kuadrit ekzistues për profesionet e rregulluara, me qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit;
- **Opsioni 2 (i preferuar)** – Hartimi i një ligji të ri, të harmonizuar plotësisht me parashikimet e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit;
- **Opsioni 3** – Hartimi i dy ligjeve që do të transpozojnë përkatësisht parashikimet e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit.
- **Opsioni 4** – Transpozimi i Direktivës 2005/36/KE me ligj të ri të veçantë dhe i Direktivës 2018/958/BE përmes ndryshimeve në Ligjin nr. 10 171/2009 “Për profesionet e rregulluara”

Opsionet e mëposhtme janë identifikuar dhe vlerësuar mbi bazën e një qasjeje të integruar analitike dhe krahasimore, për të garantuar transpozimin e drejtë dhe efektiv të **Direktivës 2005/36/KE** për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe **Direktivës (BE) 2018/958** për testin e proporcionalitetit.

Konkretisht:

- Analizat e mangësive ligjore identifikuar gjatë hartimit të tabelës së përputhshmërisë (TOC);
- Gjetjet në kuadër të procesit të “screening”;
- Analizat krahasuese të legjislacionit të shteteve anëtare të BE-së, si Kroacia, Bullgaria dhe Sllovenia (që kanë zgjedhur një ligj të unifikuar), Portugalia (që ka ndjekur modelin e integruar), etj;
- Rekomandimet e Komisionit Evropian dhe udhëzimet përkatëse për zbatimin e Direktivave, të cilat theksojnë rëndësinë e qasjes horizontale, të koordinuar dhe të lehtë për t’u zbatuar për qëllimet e anëtarësimit.

Opsioni 1 - *Ndërhyrje të targetuara në aktet ligjore e nënligjore sektoriale pjesë të kuadrit rregullator ekzistues për profesionet e rregulluara, me qëllim përafrimin e plotë të legjislacionit shqiptar me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit*

Ndërhyrja në aktet ligjore e nënligjore pjesë të kuadrit ekzistues për profesionet e rregulluara është e pashmangshme në përafrimin dhe implementimin e plotë të Direktivës 2005/36/KE dhe Direktivës (BE) 2018/958, por një ndërhyrje e tillë do të duhet të jetë e organizuar nën një ligj horizontal i cili do të orientojë ndryshimet e nevojshme në mënyrë të unifikuar dhe do të mirëpërcaktojë autoritetet kompetente.

Duke marrë parasysh se Direktiva 2005/36/KE dhe Direktiva (BE) 2018/958 synojnë promovimin dhe lehtësimin e lëvizjes së lirë të profesionistëve brenda tregut të përbashkët, dhe nga ana tjetër, legjislacioni vendas për profesionet e rregulluara synon rregullimin e ushtrimit të profesioneve të caktuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, shihet me vend që *acquis* në fjalë të transpozohet përmes një akti të posaçëm, duke evidentuar efektin e tij horizontal, dhe duke ruajtur balancën midis rregullimeve vendase për profesionet, dhe rregullimeve në kuadër të sistemeve të njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, të cilat do të bëhen tërësisht të zbatueshme nga momenti i anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Në çdo rast, ndryshimet në aktet ligjore e nënligjore të posaçme për profesionet e rregulluara do të kenë në fokus harmonizimin e legjislacionit vendas me *acquis communautaire*, dhe përshtatjen e rregullave të sanksionuara në këto akte me parimet dhe frymën e parashikimeve të sanksionuara nga akti i posaçëm që do të transpozojë Direktivën 2005/36/KE dhe Direktivën (BE) 2018/958.

Gjithashtu, vlen të theksohet se ndërhyrja eventuale në një sërë aktesh të posaçme duke pasur si pikë referimi një instrument koordinues me shtrirje horizontale që përafron Direktivën 2005/36/KE dhe Direktivën (BE) 2018/958, synon të shmangë mundësinë e një dështimi rregullator, duke garantuar njësimin e efekteve të ardhura nga ndryshimet e secilit akt dhe transpozimin efektiv të *acquis communautaire* në fushën e njohjes së kualifikimeve.

Opsioni 2 (i preferuar) - *Hartimi i një ligji të ri, të harmonizuar plotësisht me parashikimet e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit*

Bazuar në rezultatet e analizës gjithëpërfshirëse të legjislacionit vendas në kuadër të procesit *screening* dhe kryesisht të gjetjeve dhe rekomandimeve të paraqitura në Udhërrëfyesin për përafrimin me *acquis* për njohjen e kualifikimeve profesionale, opsioni më efektiv rezulton të jetë miratimi i një ligji horizontal, i cili do të zbatohet thujse për të gjitha profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë.

Ky ligj, duke qenë një akt me efekt horizontal, do të krijojë premisën për reflektimin e kushteve dhe standardeve të Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit në legjislacionin sektorial.

Qëllimi i ndërhyrjes, pra përafrimi tërësor i legjislacionit me *acquis communautaire* do të realizohet në mënyrë të përshkallëzuar, fillimisht me hartimin e ligjit të posaçëm (nisma e propozuar) e më pas me ndryshimin dhe përshtatjen e tërësisë së akteve sektoriale të cilat do të reflektojnë parimet dhe frymën e këtij ligji që do të transpozojë Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 për testin e proporcionalitetit.

Zgjedhja për të transpozuar Direktivën për proporcionalitetin brenda të njëjtit akt ligjor me Direktivën 2005/36/KE është një çështje koherence rregullatore dhe efikasiteti legjislativ.

Ndërsa në teori, Direktiva për proporcionalitetin mund të transpozohet përmes një akti të veçantë ligjor, integrimi i të dyjave në një ligj të vetëm përfaqëson qasjen e preferuar. Kjo për faktin se ato ndajnë të njëjtin fushëveprim personal dhe material, si dhe përdorin terminologji dhe logjikë strukturore të përbashkët. Duke qenë se ka mbivendosje të qarta, zbatimi i përbashkët në një kuadër të unifikuar ligjor shmang referencat e panevojshme ndërmjet akteve të ndryshme, siguron koherencë të brendshme më të mirë dhe thjeshton interpretimin dhe zbatimin si për ligjvënësit, ashtu edhe për institucionet përgjegjëse për zbatimin.

Nga pikëpamja e hartimit ligjor, bashkimi i të dy Direktivave në një akt të vetëm përmirëson qartësinë, rrit efektivitetin në zbatim dhe krijon një kuadër rregullator më të integruar dhe të lehtë për t'u përdorur në fushën e njohjes dhe rregullimit të kualifikimeve profesionale.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë praktikën e vendeve të tjera të rajonit në implementimin e *acquis* në fjalë, do të parashikohet shprehimisht hyrja në fuqi e dispozitave për njohjen e ndërsjellë nga momenti i anëtarësimit të plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Opsioni 3 – Hartimi i dy ligjeve që do të transpozojnë përkatësisht parashikimet e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit

Siç analizohet edhe më sipër, Direktiva (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit synon të njësojë rregullat e zbatimit të testit të proporcionalitetit në rast të miratimit të rregullimeve të reja për profesionet nga shtetet anëtare të BE-së në funksion të rritjes së efektivitetit të zbatimit të Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Duke marrë në konsideratë ndërlidhjen dhe synimet qenësisht të përbashkëta të Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit dhe Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale, transpozimi i të dyja Direktivave me të njëjtin ligj paraqitet si një opsion më efektiv dhe koherent për qëllim të implementimit të duhur. Si përmendur më lart Direktivat ndajnë të njëjtin fushëveprim personal dhe material, si dhe përdorin terminologji dhe logjikë strukturore të përbashkët. Duke qenë se ka mbivendosje të qarta, zbatimi i përbashkët në një kuadër të unifikuar ligjor shmang referencat e panevojshme ndërmjet akteve të ndryshme, siguron koherencë të brendshme më të mirë dhe thjeshton interpretimin dhe zbatimin si për ligjvënësit, ashtu edhe për institucionet përgjegjëse për zbatimin.

Zbatimi përmes dy ligjeve mund të shkaktojë konflikte interpretimi, referenca të ndërsjella të panevojshme dhe mbivendosje institucionale për testin e proporcionalitetit, veçanërisht në rastet e rregullimit të profesioneve të reja.

Gjithashtu, bazuar në hulumtimet e kryera sa i përket transpozimit në shtete të tjera anëtare të BE-së, konkretisht Kroaci, Bullgari dhe Slloveni, është parë se detyrimet që vendos Direktiva (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit janë përfshirë në aktin që ka transpozuar edhe Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Rrjedhimisht, ky opsion nuk preferohet duke marrë në konsideratë efektivitetin në implementim.

Opsioni 4 – Transpozimi i Direktivës 2005/36/KE me ligj të ri të veçantë dhe i Direktivës 2018/958/BE përmes ndryshimeve në Ligjin nr. 10 171/2009 “Për profesionet e rregulluara”

Ky opsion konsiston në miratimin e një ligji të ri për transpozimin e plotë të Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale, ndërkohë që dispozitat e Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit do të përfshihen nëpërmjet ndryshimeve në Ligjin nr. 10 171/2009 “Për rregullimin e profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë”.

Megjithatë, ky option nuk rekomandohet, për arsye të mëposhtme:

1. Shkalla e lartë e ndërhyrjes në ligjin ekzistues – Për të përfshirë mekanizmat e kërkuar nga Direktiva 2018/958/BE, do të duhej një ndërhyrje thelbësore në strukturën dhe përmbajtjen e ligjit 10 171, me rishkrim mbi 50% të dispozitave të tij, çka praktikisht do të kërkonte një ligj të ri dhe jo vetëm amendime.
2. Kërkon reformim konceptual – Do të kërkohej një riformulim i qasjes rregullatore, për të larguar kriteret e tepër të ngushta të parashikuara aktualisht dhe për të qartësuar statusin e UP-ve (ushtruesve të profesioneve të rregulluara) dhe procedurat e vendimmarrjes ndër-institucionale.
3. Vështirësi në bashkërendim institucional – Ndryshimet në ligjin 10 171 nuk do të ishin të mjaftueshme për të garantuar zbatimin efektiv të neneve 57 dhe 59 të Direktivës 2005/36/KE mbi sistemet e informacionit dhe bashkëpunimin administrativ (IMI, EPC, Pika e Vetme e Kontaktit), që kërkojnë një instrument të qartë horizontal dhe të detajuar.

Për rrjedhojë, ky option nuk siguron as koherencë të brendshme, as efikasitet legjislativ, dhe ngre rreziqe për fragmentim zbatues në fazën e integritimit në BE.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo option (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura nga përafrimi tërësor i kuadrit ligjor vendas me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit janë qeveria dhe autoritetet publike, profesionistët, urdhrat profesionalë, IAL-të, studentët dhe profesionistët e kualifikuar të tashëm e të ardhshëm, punëdhënësit/bizneset vendase, si edhe qytetarët si përfitues shërbimesh.

➤ **Qeveria autoritetet publike (përfshirë Urdhrat Profesionalë):**

Ndikimi i drejtpërdrejtë: Sjell nevojën për përshtatje të konsiderueshme ligjore, sfida në alokimin e burimeve dhe zbatimin e trajnimeve gjithëpërfshirëse për 4shkak të futjes së testit të proporcionalitetit dhe sistemit të ri të njohjes së kualifikimeve. Po ashtu, administrata publike do të duhet të zhvillojë kapacitete të reja për të vlerësuar në mënyrë të rregullt masat rregullatore për profesione të rregulluara, duke garantuar që ato janë të justifikuara, të nevojshme dhe proporcionale në përputhje me *acquis*-në e BE-së.

Një nga ndikimet kryesore të këtij kuadri ligjor do të jetë **përshtatja dhe përafrimi i veprimtarive të Urdhrave Profesionalë**, me fokus në **heqjen e pengesave për ushtrimin e profesioneve të rregulluara në nivel rajonal dhe evropian**. Në rolin e tyre si rregullatorë, Urdhrat Profesionalë do të preken drejtpërdrejt nga zbatimi i kuadrit të ri ligjor. Ata do të kenë **detyrime të reja**, përfshirë **lëshimin e dëshmive dhe certifikatave** për njohjen e kualifikimeve profesionale, si dhe **ndërveprimin me sistemin IMI** për qëllime koordinimi me homologët në vendet e Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, Urdhrat Profesionalë do të përfshihen në **vlerësime paraprake (ex ante assessments)** për të justifikuar rregullimet që propozojnë për profesionet që mbulojnë. Këto zhvillime nënkuptojnë **nevojën për rishikim të kapaciteteve të tyre institucionale** dhe për një **bashkërendim më të ngushtë me administratën publike qendrore**, për të siguruar përputhshmëri të plotë me kërkesat e *acquis communautaire*.

Ndikimi indirekt: Nga një perspektivë tregu dhe shteti, ndikimet indirekte përfshijnë përparim të ndjeshëm në shkallën e përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis*-në e BE-së dhe pasoja të shtuar financiare për buxhetin e shtetit, si pasojë e nevojës për zbatim efektiv dhe mirëmbajtje të mekanizmave të rinj të kontrollit dhe vlerësimit rregullator. Gjithashtu, pritet një rritje e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale në hartimin dhe rishikimin e rregulloreve profesionale.

Përsa u takon urdhrave profesionalë, një ndikim i tërthortë do të jetë edhe rritja e bashkëpunimit me homologët në vendet e tjera të BE-së, duke mundësuar shkëmbimin e praktikave më të mira dhe të njohurive.

Zhvillimi ekonomik në kuadër të tregut rajonal dhe evropian nëpërmjet vendosjes së bazave për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale. Përparim i konsiderueshëm në realizimin e objektivave të marrëveshjeve rajonale për njohjen e kualifikimeve profesionale për profesionet sektoriale në sajë të inkurajimit të lëvizjes së profesionistëve dhe rritjes së produktivitetit të tregut. Zhvillim i mëtejshëm në kuadër të implementimit të politikave që i përgjigjen standardeve të integritetit evropian.

Gjithashtu, si rezultat i implementimit të një kuadri analitik për zbatimin e testit të proporcionalitetit në përputhje me parashikimet e Direktivës (BE) 2018/958, si një masë *ex-ante* në rast të prezantimit të rregullave të reja për ushtrimin e profesioneve, do të garantohet minimizimi i rregullimeve të tepërta që do të cenonin ushtrimin e lirë të profesioneve të rregulluara, si edhe shmangien e pengesave burokratike për lëvizjen e lirë të profesionistëve të kualifikuar.

Gjithashtu, bazuar në Strategjinë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2021-2025¹² ("**Strategjia për Diasporën 2021-2025**"), një nga objektivat kryesore të qeverisë është edhe nxitja e profesionistëve shqiptarë të kualifikuar jashtë vendit për të ushtruar profesionin e tyre apo për të ofruar shërbime në vendin e tyre, duke zbutur kështu edhe fenomenin e "largimit të trurit" (*brain drain*).

Nëpërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit, do të hidhen bazat për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, duke shmangur pengesat burokratike për kthimin e shqiptarëve të

¹² Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021-2025, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.585, datë 22.7.2020.

diasporës në vendin e tyre dhe rritjen e përfitimeve socio-ekonomike të vendit si rezultat i ekspertizës së tyre.

➤ **Profesionistët:**

Ndikimi i drejtpërdrejtë: Qasje më e lehtë në tregun shqiptar të punës për profesionistët e kualifikuar në vende të tjera të BE-së.

Ndikimi jo i drejtpërdrejtë: Rritja e konkurrencës, që mund të çojë në shërbime me cilësi më të lartë dhe zhvillim të mëtejshëm të aftësive profesionale të personave të kualifikuar për të ofruar shërbimet në fjalë.

➤ **IAL-të:**

Ndikimi i drejtpërdrejtë: IAL-të do të kenë rol në vlerësimin e të drejtave të fituara për shtetasit shqiptarë, përmes vënies në dispozicion të kurrikulave dhe dokumentacionit historik, që do t'u shërbejë autoriteteve kompetente për të vlerësuar përputhshmërinë e kualifikimeve ekzistuese me kuadrin e ri.

Në mënyrë të tërthortë, kjo ndërhyrje mund të kontribuojë në rritjen e besueshmërisë dhe të njohjes ndërkombëtare të IAL-ve shqiptare, duke rritur potencialisht tërheqjen e studentëve të huaj dhe duke frenuar largimin e studentëve shqiptarë jashtë vendit për arsye të njohjes më të favorshme të diplomave.

Ndikimi jo i drejtpërdrejtë: Rritja e reputacionit dhe njohjes për IAL-të shqiptare duke tërhequr potencialisht më shumë studentë të huaj, si edhe duke shmangur largimin e studentëve shqiptarë jashtë vendit.

➤ **Studentët dhe profesionistët e ardhshëm të kualifikuar:**

Ndikimi i drejtpërdrejtë: Rritja e mundësive për ushtrimin e veprimtarisë profesionale brenda BE-së, si rezultat i njohjes së kualifikimeve të tyre shqiptare.

Ndikimi jo i drejtpërdrejtë: Rritja e motivimit për të ndjekur studimet dhe karrierën në profesione të rregulluara për shkak të perspektivave të zgjeruara të lëvizshmërisë brenda rajonit dhe BE-së.

➤ **Punëdhënësit/Bizneset vendase:**

Ndikimi i drejtpërdrejtë: Rritja e numrit të profesionistëve të kualifikuar si kandidatë potencialë për pozicione që kërkojnë aftësi teknike dhe kualifikime të posaçme, duke reduktuar potencialisht kostot dhe kohën e procedurave të marrjes në punë.

Ndikimi jo i drejtpërdrejtë: Rritja e konkurrencës dhe inovacionit për shkak të qasjes në një gamë të ndryshme aftësish dhe ekspertize, si edhe për shkak të lehtësimit të pengesave për marrjen në punë të profesionistëve të kualifikuar në vendet e BE-së.

➤ **Qytetarët si përfitues shërbimesh:**

Ndikimi i drejtpërdrejtë: Qasje në një gamë më të gjerë profesionistësh të kualifikuar, që mund të çojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve si rezultat i rritjes së konkurrencës.

Ndikimi jo i drejtpërdrejtë: Rritja e të ardhurave për shkak të efekteve pozitive në tregun e punës dhe në aktivitetet tregtare.

➤ **Përmbledhje e vlerësimit të ndikimeve**

Si rezultat i detyrimit të shtetit shqiptar për përafrimin e plotë të kuadrit rregullativ vendas me parashikimet e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit, ndërmarrja e nismave ligjvënëse me qëllim zbatimin e këtij detyrimi është e pashmangshme. Pavarësisht mekanizmit juridik që do të ndërmerret për realizimin e qëllimeve, efektet e këtyre ndryshimeve do të prekin në çdo rast të gjitha grupet e mësipërme.

Megjithatë, në rastin e opsionit nr.2, efektet si rezultat i prezantimit të standardeve të reja për rregullimin e profesioneve dhe njohjen e kualifikimeve profesionale do të jenë më të zbutura, për shkak se do të koordinohen nga një akt ligjor me efekt horizontal (nisma e propozuar) që do të mundësojë përafrimin tërësor të legjislacionit vendas me Direktivat në fjalë në mënyrë të organizuar dhe të përshkallëzuar.

➤ **Vlerësimi i Ndikimit Gjinor dhe Social (VNGjS) për projektligjin “Mbi sistemet e njohjes së kualifikimeve profesionale”**

Transpozimi i Direktivës 2005/36/EC mbi njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit në ligjin shqiptar ofron një mundësi të rëndësishme jo vetëm për avancimin e barazisë gjinore brenda mjedisit profesional, por edhe për adresimin e pabarazive sociale që ndikojnë grupe të ndryshme të popullsisë në të njëjtin mjedis. Në këtë kuadër, Vlerësimi i ndikimit gjinor dhe social synon të analizojë se si zbatimi i këtyre Direktivave mund të ndikojë tek gratë dhe burrat, si dhe te grupet në situatë vulnerabël – përfshirë të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet etnike, migrantët e kthyer duke siguruar që procesi i transpozimit të promovojë barazinë gjinore dhe të adresojë pabarazitë ekzistuese.

Për të arritur në konkluzione vlerësimi merr në konsideratë një gamë të gjerë ndikimesh në nivel kombëtar mbi autoritetet publike, urdhrat profesionalë, institucionet e arsimit të lartë, punëdhënësit, bizneset apo qytetarët në terma më të përgjithshëm. Brenda këtyre fushave—veçanërisht aty ku institucionet dhe politikat kombëtare rregullojnë aksesin dhe ushtrimin e profesioneve—ekziston një hapësirë e konsiderueshme për të integruar qasjen gjinore dhe sociale, si pjesë e testit të proporcionalitetit dhe reformave institucionale.

Edhe pse vetë Direktivat janë gjinore dhe sociale neutralë, konteksti kombëtar i zbatimit ofron hapësira për ndërhyrje të ndjeshme ndaj grupeve të marginalizuara. Këto ndërhyrje mund të synojnë reduktimin e barrierave strukturore që përjetojnë:

- Gratë në sektorët ku janë të nënpërfaqësuar dhe përballen me sfida si puna e papaguar e kujdesit dhe ndarja gjinore e profesioneve;
- Të rinjtë që kanë përfunduar arsimin jashtë Shqipërisë dhe përballen me procedura jo të qarta për njohjen e kualifikimeve të tyre;
- Migrantët e kthyer, të cilët sjellin përvoja dhe trajnime të fituara jashtë sistemit kombëtar, por nuk kanë mundësi të lehtë për integrim profesional;
- Personat me formim praktik ose joformal, që shpesh përjashtohen nga mekanizmat formalë të njohjes së aftësive;
- Anëtarët e pakicave etnike dhe komunitetit rom, të cilët përballen me diskriminim shumëdimensional në qasjen në arsim dhe punësim;

Personat me aftësi të kufizuara (PAK), që mund të përballen me barriera fizike dhe institucionale për të hyrë në profesione të rregulluara.

Konsiderata të përgjithshme gjinore dhe sociale

Projektligji ka ndikime të dukshme si në aspektin gjinor ashtu edhe atë social. Përtej barazisë mes grave dhe burrave, ai prek kategori të gjera qytetarësh, veçanërisht ata me akses të kufizuar në arsim dhe treg pune. Sipas raportit "*Burrat dhe Gratë në Shqipëri 2023*" hartuar nga INSTAT (2023), gratë janë të nënpërfaqësuar në pozicionet e nivelit të lartë dhe në fushat që kërkojnë kualifikime të avancuara.

Në vitin 2022, gratë përbënin 50.5% të popullsisë totale, por përballeshin me barriera të konsiderueshme në qasjen në arsim dhe punësim krahasuar me burrat. Norma neto e migracionit për gratë ishte -12496 krahasuar me -20001 për burrat, duke treguar një lëvizje të konsiderueshme jashtë vendit që ndikon në shpërndarjen gjinore në fuqinë punëtore profesionale.

Direktiva 2005/36/EC synon të lehtësojë njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale në shtetet anëtare të BE-së. Nga kjo iniciativë mund të përfitojnë në mënyrë të konsiderueshme gratë, veçanërisht në fushat ku ato janë të nën-përfaqësuara. Thjeshtimi i procesit të njohjes për kualifikimet e fituara jashtë vendit mund të ndihmojë gratë që kanë përballur barriera në qasjen në arsim dhe trajnim të avancuar të ushtrojnë profesionet e tyre më lehtë në Shqipëri. Për këtë arsye është e rëndësishme që kuadri ligjor i rishkruar në drejtim të përafrimit me Direktivën të marrë në konsideratë situatën e grave/burrave në këtë fushë me qëllim që të sigurohet që gratë, të kenë mundësi të përfitojnë dhe t'u garantohet qasja e njëjtë në të gjitha profesionet e rregulluara sipas parashikimeve të Direktivës.

Nga ana tjetër, Direktiva (BE) 2018/958 kërkon që çdo rregullim i ri mbi profesionet të jetë proporcional dhe i justifikuar. Kjo Direktivë mund të ndihmojë në parandalimin e praktikave diskriminuese që prekin në mënyrë disproporcionale gratë. Për shembull, sigurimi që rregullimet e reja të mos krijojnë barriera të panevojshme për gratë që kthehen në punë pas lejes së lindjes ose për ato që kërkojnë pozicione me kohë të pjesshme mund të promovojë një barazi më të madhe gjinore. Duke vendosur kritere të qarta dhe objektive për rregullimet profesionale, Direktiva mbështet krijimin e një ambienti profesional më gjithëpërfshirës dhe fleksibël.

Ndikimet sociale të projektligjit janë të shumanshme dhe thellësisht të ndërlidhura me transpozimin e dy Direktivave të BE-së – Direktivës 2005/36/EC dhe Direktivës (BE) 2018/958 – të cilat rregullojnë njohjen e kualifikimeve dhe proporcionalitetin në ushtrimin e profesioneve. Në kontekstin shqiptar, këto dispozita nuk janë vetëm teknike apo procedurale, por kanë potencial të qartë për të ndikuar në mënyrë pozitive përfshirjen sociale dhe për të trajtuar pabarazitë e trashëguara për grupe që tradicionalisht janë të përjashtuara nga tregu i punës dhe nga profesionet e rregulluara.

Për shembull, të rinjtë që diplomohen jashtë Shqipërisë – një grup në rritje që përfshin mbi 30,000 studentë në vitin 2022 – përballen me vështirësi në integrimin profesional në atdhe për shkak të mungesës së një mekanizmi efikas të njohjes së diplomave. Vetëm rreth 18% e tyre arrijnë të njohin diplomën brenda 6 muajve nga kthimi, duke rritur rrezikun e emigrimit të përhershëm dhe humbjen e kapitalit njerëzor (brain drain). Transpozimi i Direktivës 2005/36/EC mund të ndihmojë në përmirësimin e këtij procesi duke garantuar qartësi, transparencë dhe afate të përcaktuara për njohjen automatike ose të lehtësuar të diplomave, duke ruajtur kështu potencialin profesional të të rinjve shqiptarë.

Një tjetër kategori me rëndësi janë migrantët e kthyer, të cilët përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë aktive – rreth 130,000 që nga viti 2015 – me afro 40% të tyre që zotërojnë njohuri dhe aftësi të fituara jashtë sistemit formal të arsimit. (INSTAT 2024). Në mungesë të një mekanizmi të qëndrueshëm për vlerësimin e kompetencave të fituara në mënyrë joformale ose në kontekste të tjera kombëtare, këta individë rrezikojnë të mbeten të papunë ose të mbipërfaqësuar në sektorë informalë. Përmes testit të proporcionalitetit dhe aplikimit fleksibël të kriterëve për njohje, projektligji mund të kontribuojë në zhbllokimin e potencialit të kësaj kategorie.

Gjithashtu, personat që kanë përvojë praktike ose formim joformal – që përbëjnë rreth 22% të të punësuarve në Shqipëri – kanë qenë historikisht të përjashtuar nga njohja zyrtare e aftësive të tyre. Një kornizë e qartë që pranon format alternative të të mësuarit, në përputhje me parimet e Direktivave të BE-së, do të ndihmonte

në përfshirjen e tyre të drejtë në tregun formal të punës dhe do të kontribuonte në uljen e pabarazive strukturore.

Në aspektin etnik dhe kulturor, minoritetet romë dhe egjiptianë mbeten ndër grupet më të marginalizuara. Me një përfaqësim të ulët në arsim profesional (rreth 3%) dhe sfida në qasjen në kualifikime të njohura, këto grupe përfitojnë drejtpërdrejt nga një sistem gjithëpërfshirës njohjeje. Sipas Censusit 2023, afërsisht 1% e popullsisë kanë deklaruar përkatësinë në këto minoritete (Census 2023). Një qasje universale dhe e paanshme ndaj njohjes së kualifikimeve do të siguronte që diskriminimi i bazuar në etni të reduktohej ndjeshëm.

Për popullsinë imigrante – 108,503 persona sipas Censusit 2023, me shumicën (77.1%) në grupmoshën 15–64 vjeç – integrimi në tregun e punës është një sfidë e vazhdueshme. Shumë prej tyre vijnë nga kontekste të ndryshme formimi profesional dhe përballen me barriera për shkak të mungesës së dokumentacionit ose mosnjohjes së sistemit vendas. Harmonizimi me standardet e BE-së për njohjen e kualifikimeve do të lejonte që kjo popullsi të kontribuonte më efektivisht në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Gjithashtu, për personat me aftësi të kufizuara – që përfaqësojnë rreth 6.5% të popullsisë mbi moshën 5 vjeç (afërsisht 156,138 individë), nga të cilët shumica janë gra dhe të moshuar – projektligji krijon mundësi reale për përmirësimin e aksesit në profesionet e rregulluara. Duke integruar dispozita që adresojnë nevojat e tyre, përmes njohjes së përvojave alternative ose kushteve të përshtatura për vlerësim, Shqipëria mund të avancojë më tej në përmbushjen e parimeve të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Sa më sipër, përmes transpozimit të kujdesshëm dhe gjithëpërfshirës të dy Direktivave të BE-së, projektligji për njohjen e kualifikimeve profesionale ka potencialin të veprojë si një mjet transformues për drejtësi sociale dhe përfshirje, duke garantuar që asnjë grup të mos mbetet prapa në qasjen ndaj tregut të punës dhe ushtrimit të profesionit.

Diskrecioni rregullator në nivel kombëtar

Zbatimi i Direktivës (BE) 2018/958—në mënyrë të veçantë aplikimi i testit të proporcionalitetit për rregulloret e reja ose të ndryshuara kombëtare mbi profesionet—ofron një pikë hyrëse thelbësore për analizën gjinore dhe sociale. Ndërkohë që parimi i proporcionalitetit nuk përfshin në thelb kritere gjinore apo sociale, diskrecioni i rregullatorëve kombëtarë në propozimin, vlerësimin dhe arsyetimin e këtyre rregulloreve mund dhe duhet të marrë në konsideratë se si masat e propozuara ndikojnë ndryshe tek grupet vulnerabël.

Për shembull:

- Kriteret për përvojë pune të vazhdueshme mund të përjashtojnë gratë që kanë ndërprerje karriere për shkak të detyrimeve të kujdesit familjar.
- Kërkesat për trajnime intensive në vende të largëta ose me kosto të lartë ndikojnë më shumë individët me të ardhura të ulëta ose ata që punojnë me kohë të pjesshme.
- Tarifat e licencimit dhe kostot e provimeve ose kurseve certifikuese mund të jenë barriera reale për personat nga familje në nevojë ose grupet e marginalizuara (si romët, egjiptianët, PAK apo migrantët e kthyer).
- Kriteret fizike për disa profesione nuk parashikojnë përshtatje për personat me aftësi të kufizuara.

Për të adresuar këto aspekte, sugjerohet që çdo raport analize për testin e proporcionalitetit të përfshijë një seksion të dedikuar për ndikimin gjinor dhe social, me pyetje udhëzuese specifike dhe vlerësim të ndarë sipas grupeve të synuara. Përfshirja e të dhënave statistikore dhe konsultimi me aktorët e interesuar

(p.sh., organizata për barazi gjinore, përfaqësues të komuniteteve minoritare, organizatat e personave me aftësi të kufizuara) duhet të bëhen pjesë integrale e procesit rregullator.

Në këtë mënyrë, Shqipëria jo vetëm që përmbush detyrimet e saj për transpozimin e legjislacionit të BE-së, por përdor fleksibilitetin kombëtar për të ndërtuar politika më të drejta, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj kontekstit shoqëror dhe gjinor të vendit.

Ndikimet ekonomike dhe sociale

Transpozimi i këtyre Direktivave në legjislacionin shqiptar pritet të sjellë përfitime të konsiderueshme në aspektin ekonomik dhe social, përmes rritjes së mobilitetit profesional, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe avancimit të standardeve profesionale në vend. Këto përfitime janë veçanërisht të rëndësishme për grupet që aktualisht përballen me kufizime strukturore në tregun e punës, përfshirë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe migrantët e kthyer.

Për gratë, implementimi i drejtpërdrejtë i Direktivave mund të përkthehet në më shumë mundësi për të ushtruar profesionet e tyre, të kenë qasje më të drejtë në tregun e punës dhe të rrisin potencialin e tyre për të hyrë në pozita më të paguara dhe drejtuese. Megjithatë, ndikimet e mundshme pozitive nuk janë të garantuara në mungesë të politikave shoqëruese që adresojnë hendekun gjinor në paga, përfaqësimin e ulët në drejtim dhe sfidat e veçanta në sektorë ku gratë janë të mbipërfaqësuara, si kujdesi shëndetësor, arsimi dhe punët sociale. Këta sektorë, megjithëse esenciale, shpesh ofrojnë më pak mundësi për avancim dhe janë të nënvlerësuar ekonomikisht.

Sipas INSTAT (2023), mosha mesatare e martesës për gratë është 27.8 vjeç dhe për burrat 31.2 vjeç. Kjo diferencë, së bashku me rolet tradicionale gjinore, ndikon në kufizimin e kohës dhe fleksibilitetit që gratë kanë për të ndjekur karriera të avancuara. Prandaj, transpozimi i ligjit duhet të parashikojë masa që mundësojnë qasje më të barabartë dhe fleksibilitet të nevojshëm për kategori të ndryshme sociale dhe gjinore.

Ndikimi në Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL)

Institucionet e Arsimit të Lartë do të luajnë një rol kritik në përafrimin e kurrikulave të tyre me Direktivat për të lehtësuar njohjen e kualifikimeve. Ky përafrim duhet të jetë jo vetëm teknik, por edhe socialisht dhe gjinorësisht i ndjeshëm. Ky përafrim duhet të fokusohet gjithashtu në promovimin e politikave arsimore të ndjeshme ndaj gjinisë që inkurajojnë gratë të ndjekin studimet në fusha ku ato janë tradicionalisht të nën-përfaqësuara, si STEM (Shkenca, Teknologjia, Inxhinieria dhe Matematika). Gjithashtu IAL-të inkurajohen të zhvillojnë dhe zbatojnë:

- Udhëzues për integrimin e perspektivës gjinore në arsim dhe kurrikula, si mjet trajnues dhe rregullator për stafin akademik dhe administrativ;
- Kuota gjinore balancuese në organet drejtuese akademike dhe në strukturat që merren me rishikimin e programeve të studimit;
- Mekanizma për mbledhjen dhe analizën e të dhënave të ndara sipas gjinisë mbi regjistrimet, diplomimet dhe punësimin e studentëve, për të ndjekur ndikimin e politikave arsimore.

Në të njëjtën kohë, kriteret e ndjeshmërisë gjinore duhet të bëhen pjesë e proceseve të akreditimit institucional, duke u përfshirë si tregues në vlerësimin e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë.

Duke promovuar një ambient arsimor gjithëpërfshirës, IAL-të mund të ndihmojnë në mbylljen e hendekut gjinor në kualifikimet profesionale dhe të sigurojnë që gratë të jenë të përgatitura mirë për të përfituar nga mundësitë e reja.

Ndikimi në urdhërat profesionale

Urdhrat profesionalë zënë një vend të rëndësishëm në arkitekturën institucionale të zbatimit të projektligjit, pasi ata janë përgjegjës për proceset e njohjes, licencimit dhe rregullimit të ushtrimit të profesioneve të rregulluara. Me hyrjen në fuqi të rregullave të reja në përputhje me Direktivat 2005/36/EC dhe (BE) 2018/958, këto struktura pritet të përshtasin jo vetëm standardet e tyre profesionale dhe procedurat teknike, por edhe të zhvillojnë një qasje më gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj dimensioneve gjinore dhe sociale të ushtrimit të profesionit.

Kjo kërkesë bëhet edhe më e rëndësishme në kushtet kur disa nga rregullat ekzistuese, si për shembull kërkesat për përvojë të pandërprerë pune, tarifat e larta të licencimit apo trajnime të detyrueshme që kërkojnë angazhim fizik intensiv, mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek gratë, veçanërisht ato që rikthehen në tregun e punës pas një periudhe leje prindërore ose që punojnë me kohë të pjesshme. Po kështu, këto kritere mund të përjashtojnë në mënyrë të pavullnetshme edhe kategori të tjera si personat me aftësi të kufizuara apo migrantët e kthyer që kanë zhvilluar aftësi në mënyrë informale jashtë vendit.

Në këtë kuadër, është thelbësore që urdhrat profesionalë të zhvillojnë instrumente të posaçme që nxisin barazinë dhe gjithëpërfshirjen. Ndër to përfshihen hartimi i udhëzuesve për ndjeshmëri gjinore dhe sociale, përfshirja e kuotave balancuese gjinore në bordet dhe komisionet e tyre drejtuese, si dhe mbledhja sistematike e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe grupeve sociale mbi aplikantët, licencimet dhe ushtruesit e profesionit. Këto masa do të ndihmonin jo vetëm në parandalimin e diskriminimit të pavetëdijshëm, por edhe në krijimin e një kulture institucionale që promovon diversitetin dhe barazinë në profesion.

Po ashtu, sugjerohet që vlerësimi institucional periodik i urdhrave profesionalë të përfshijë indikatorë të ndjeshmërisë gjinore dhe sociale, si pjesë e standardeve të cilësisë për funksionimin e tyre. Në këtë mënyrë, urdhrat profesionalë nuk do të jenë thjesht instrumente zbatimi të ligjit, por agjentë aktivë të ndryshimit social që kontribuojnë në ndërtimin e një mjedisi profesional më të drejtë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë.

Ndikimi në studentët dhe profesionistët e ardhshëm

Për studentët dhe profesionistët e ardhshëm, transpozimi i këtyre Direktivave do të zgjerojë mundësitë për të ushtruar profesionet e tyre brenda BE-së. Ky mobilitet i rritur është veçanërisht përfitues për gratë që mund të përballen me barriera më të mëdha në vendin e tyre të origjinës. Inkurajimi i grave të reja për të ndjekur kualifikime profesionale dhe sigurimi që ato janë të informuara për mundësitë e disponueshme sipas kuadrit të ri ligjor është thelbësor. Gjithashtu, ofrimi i mbështetjes dhe burimeve për të ndihmuar gratë të navigojnë procesin e njohjes mund të përmirësojë perspektivat e tyre të karrierës dhe zhvillimin profesional.

Ndikimi në punëdhënësit dhe bizneset

Punëdhënësit dhe bizneset do të përfitojnë nga një numër më i madhe profesionistësh të kualifikuar. Kjo konkurrencë e rritur mund të nxisë inovacionin dhe të përmirësojë cilësinë e shërbimeve. Megjithatë, punëdhënësit duhet të inkurajohen të zbatojnë praktika rekrutimi të ndjeshme ndaj gjinisë për të siguruar që gratë të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga këto mundësi të reja. Hartimi i një kuadri ligjor të ndjeshëm gjinor në këtë fushë, do t'i hapte rrugë edhe miratimit të politikave të ndjeshme gjinore nga vetë punëdhënësit/bizneset duke adresuar barrierat për punësimin e grave dhe duke krijuar më shumë mundësi punësimi për gratë pjesë e këtyre profesioneve.

Ndikimi në qytetarët si përfitues të shërbimeve

Qytetarët, si përfituesit kryesorë të shërbimeve të ofruara nga profesionistët e rregulluar, do të jenë ndër përfituesit më të drejtpërdrejtë të transpozimit të dy Direktivave. Lehtësimi i mobilitetit profesional dhe

njohja më e shpejtë e kualifikimeve do të kontribuojnë në një ofertë më të gjerë dhe më të larmishme të profesionistëve të kualifikuar në tregun shqiptar. Kjo rrit konkurrencën, cilësinë dhe diversitetin në ofrimin e shërbimeve profesionale, veçanërisht në fusha të ndjeshme si shëndetësia dhe edukimi, të cilat kanë ndikim disproporcional mbi gratë dhe grupet vulnerabël.

Për shembull, në sektorin e kujdesit shëndetësor, rritja e numrit të profesionistëve të kualifikuar, përfshirë ata të rikthyer nga jashtë apo të licencuar rishtazi përmes mekanizmave të thjeshtuar të njohjes, mund të përmirësojë aksesin e grave në shërbime cilësore dhe të specializuara. E njëjta logjikë vlen për arsimin, ku përmirësimi i standardeve profesionale dhe zbatimi i praktikave më të mira evropiane mund të ndikojë pozitivisht në përvojën dhe rezultatet arsimore të vajzave dhe grave të reja.

Në këtë drejtim, implementimi i projektligjit është në harmoni me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore 2021–2030, e cila thekson përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve publike për gratë dhe vajzat, si një mjet për fuqizimin e tyre social dhe ekonomik.

Për të garantuar që ndryshimet e sjella nga ky projektligj të reflektojnë realisht përmirësime për qytetarët, është e rekomandueshme që institucionet përgjegjëse të zhvillojnë sondazhe dhe instrumente të matshme, të ndara sipas gjinisë dhe grupeve sociale, për të vlerësuar perceptimet dhe përvojat e qytetarëve mbi cilësinë, qasjen dhe efektivitetin e shërbimeve profesionale. Këto të dhëna mund të shërbejnë jo vetëm për matjen e ndikimit, por edhe për përmirësimin e mëtejshëm të politikave publike me ndjeshmëri gjinore dhe sociale.

Korniza e monitorimit dhe vlerësimit

Ndërsa Direktivat nuk kërkojnë monitorim të ndarë sipas gjinisë, Vlerësimi i Ndikimit (VNG) njihet nevojën për monitorim të ndikimit në të gjitha grupet e prekura. Integrimi i treguesve të ndarë sipas gjinisë në kornizën kombëtare të monitorimit—veçanërisht në lidhje me aksesin profesional, lëvizshmërinë dhe rezultatet—do të sigurojë prova për të:

- Vlerësuar nëse përfitimet e ligjit janë shpërndarë në mënyrë të drejtë.
- Informuar përshtatjet në kuadrin rregullator kombëtar që përmirësojnë gjithëpërfshirjen.
- Identifikuar çdo ndikim disproporcional të paqëllimshëm në ushtrimin e profesioneve të rregulluara.
- Garantuar mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në prova për përshtatjen e kuadrit rregullator.

Për këtë qëllim, rekomandohet vendosja e treguesve të matshëm dhe të ndarë sipas gjinisë, aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike dhe statusit të migracionit, në bashkëpunim me INSTAT, ASCAL, Ministrinë e Arsimit dhe urdhrat profesionalë. Këta tregues do të duhet të përfshihen në raportimet e rregullta të zbatimit të ligjit, dhe të integrohen në Sistemin Kombëtar të Statistikave.

Tabela: Treguesit e Monitorimit Gjinor dhe Social për Zbatimin e Ligjit mbi Njohjen e Kualifikimeve Profesionale

Treguesi i Monitorimit	Burimi i të Dhënave	Institucioni Përgjegjës	Frekuenca e Raportimit
% e grave në çdo profesion të rregulluar (para/pas ligjit)	Regjistrat e licencimit	Urdhrat profesionalë	Vjetore
% e aplikimeve për njohje nga gra	Regjistrat e aplikimeve për njohje	Njësia përgjegjëse për njohjen	Vjetore

Treguesi i Monitorimit	Burimi i të Dhënave	Institucioni Përgjegjës	Frekuenca e Raportimit
% e licencave të lëshuara ndaj grave dhe burrave	Regjistrat e licencave	Urdhrat profesionalë	Vjetore
% e aplikimeve të refuzuara sipas gjinisë	Regjistrat e vendimeve	Urdhrat profesionalë / Komisionet përkatëse	Vjetore
Norma e punësimit të përfituesve pas njohjes, sipas gjinisë dhe moshës	Anketa e fuqisë punëtore / INSTAT	INSTAT	Vjetore
% e aplikimeve për njohje nga PAK, minoritetet, migrantët e kthyer	Regjistrat e aplikimeve me vetëdeklarim	Urdhrat profesionale	Vjetore
% e grave në bordet drejtuese të urdhrave profesionalë	Deklarime institucionale	Urdhrat profesionalë	Vjetore
% e programeve arsimore që përfshijnë ndjeshmëri gjinore në IAL	Raportet e vetëvlerësimit / ASCAL	ASCAL / MA	Vjetore
Niveli i përfaqësimit gjinor në sektorët STEM në IAL	Raportet statistikore të IAL	IAL / INSTAT	Vjetore

Kjo qasje do të mundësojë jo vetëm rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në zbatimin e ligjit, por edhe do të sigurojë një mekanizëm të qëndrueshëm për matjen e progresit në drejtim të barazisë gjinore dhe sociale në profesionet e rregulluara.

Sa më sipër, transpozimi i Direktivës 2005/36/KE dhe i Direktivës (BE) 2018/958 në legjislacionin shqiptar paraqet një mundësi të rëndësishme për t'u përafuar me kuadrin e BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale, ndërkohë që përdor edhe diskrecionin kombëtar për të promovuar barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale në sferën profesionale.

Megjithëse vetë Direktivat nuk përmbajnë dispozita specifike për gjininë dhe statusin social, kuadri rregullator në nivel kombëtar që rregullon aksesin dhe ushtrimin e profesioneve është vendi ku ndërhyrjet me ndjeshmëri gjinore/sociale mund dhe duhet të ndodhin. Zbatimi i testit të proporcionalitetit, zhvillimi i sistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe angazhimi me trupat profesionalë përfaqësojnë fusha ku ndikimet e diferencuara gjinore dhe sociale duhet të identifikohen dhe të zbuten.

Duke përfshirë vlerësimet e ndikimit gjinor dhe social në proceset përkatëse legjislative kombëtare, duke promovuar angazhimin gjithëpërfshirës të palëve të interesuara dhe duke adresuar pabarazitë gjinore në kalimin nga arsimi në punësim, qeveria mund të sigurojë që transpozimi i Direktivave të mos përforcojë pa dashje pabarazitë ekzistuese.

Një qasje me ndjeshmëri gjinore dhe sociale në nivel kombëtar, veçanërisht në mënyrën se si hartohen dhe zbatohen rregulloret profesionale, do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi profesional më gjithëpërfshirës

dhe të barabartë—një mjedis që mbështet plotësisht angazhimet e Shqipërisë si për integrimin në BE ashtu edhe për barazinë gjinore.

Së fundmi, përfshirja e këtij Vlerësimi të ndikimit gjinor dhe social në projektligjin "Për Sistemet e Njohjes së Kualifikimeve Profesionale" siguron që barazia gjinore dhe përfshirja sociale të jetë një parim thelbësor që drejton transpozimin e këtyre Direktivave në legjislacionin shqiptar. Duke ndërmarrë këto hapa, shteti shqiptar mund të krijojë një mjedis profesional më gjithëpërfshirës dhe të barabartë që mundëson që gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë nga çdo grup social të përfitojnë njëlloj nga sistemi i njohjes së kualifikimeve profesionale dhe punësimi në secilin prej profesioneve të rregulluara.

➤ **Analiza Financiare**

Ky vlerësim përshkruan ndikimet e pritshme ekonomike dhe financiare të përafrimit të Direktivës 2005/36/EC dhe Direktivës (BE) 2018/958 në legjislacionin shqiptar, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Një vlerësim i plotë dhe material kërkon disponueshmërinë e të dhënave të sakta, si aktuale ashtu edhe historike, për të siguruar një analizë të gjithanshme dhe të saktë.

• **Përafrimi me kuadrin e BE-së dhe kërkesat për të dhëna:**

Përafrimi me këto Direktiva përbën një hap kyç në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, me qëllim integrimin e sistemeve të njohjes së kualifikimeve profesionale dhe praktikave rregullatore me standardet e BE-së. Ky proces kërkon një analizë të kujdesshme të ndryshimeve mes legjislacionit shqiptar ekzistues dhe kërkesave të Direktivave. Për të vlerësuar në mënyrë të efektshme ndikimet e këtyre ndryshimeve, është thelbësore të ketë akses në të dhëna të besueshme, aktuale për sektorët dhe profesionet e prekura, si dhe të dhëna historike për të ndërtuar trende dhe baza krahasimi.

• **Efektet ekonomike dhe roli i të dhënave:**

Konsideratat makroekonomike: Zbatimi i këtyre Direktivave pritet të ketë ndikime në politika fiskale, politika monetare, rregullat tregtare, PBB, investime dhe konsum. Gjithashtu, pritet të ketë ndikime në nivelet e punësimit. Modelet dhe parashikimet makroekonomike të sakta kërkojnë të dhëna historike solide për të identifikuar tendencat dhe lidhjet midis variablave ekonomike, si dhe të dhëna aktuale që pasqyrojnë gjendjen aktuale të ekonomisë shqiptare.

Vlerësimi i këtyre ndikimeve kërkon ndërtimin e një modeli simulues të ndikimit ekonomik, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe INSTAT, i cili të mbështetet në të dhëna historike dhe të aktualizuara që pasqyrojnë gjendjen e ekonomisë shqiptare. Një model i tillë do të mundësonte analizën e lidhjeve ndërmjet zbatimit të kuadrit të ri ligjor dhe indikatorëve si PBB-ja, punësimi dhe eksporti i shërbimeve.

Ndikimet në financat publike: Ndryshimet pritet të ndikojnë në të ardhurat shtetërore, përfshirë të ardhurat nga taksat. Ndërsa në fazën fillestare zbatimi mund të sjellë rritje të shpenzimeve, në afat mesëm dhe të gjatë ekziston potenciali për rritje të të ardhurave dhe zhvillim ekonomik që do të ndikojë pozitivisht në financat publike. Vlerësimi i këtyre ndikimeve kërkon të dhëna historike të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë, si dhe të dhëna aktuale për të projektuar me saktësi rezultatet e mundshme.

Vlerësimi i ndikimeve financiare dhe nevoja për të dhëna:

Qeveria dhe autoritetet publike ndikohen drejtpërdrejt nga mungesa e përafrimit të plotë të legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire*, veçanërisht për sa i përket njohjes së kualifikimeve profesionale dhe testit të proporcionalitetit. Ministria e Arsimit është organi udhëheqës për krijimin e një kuadri plotësisht

të harmonizuar me standardet e BE-së. Krahas Ministrisë së Arsimit, zbatimi i plotë i Direktivës kërkon përfshirjen e gjashtë ministrive të tjera.

Një nga kostot e institucioneve qeveritare parashikohet të jetë përditësimi i materialeve mësimore, ku synohet ngritja e një strukture të posaçme për modernizimin e plotë të kurrikulës mësimore dhe shqyrtimi i nevojës për konsulencë dhe ekspertizë të mëtijshme. Bashkëpunimi ndër-institucional dhe menaxhimi i kësaj nisme përkon me kostot indirekte të parashikuara. Me rritjen e cilësisë së arsimit dhe mësimdhënies pritet një rritje e të ardhurave në institucioneve përkatëse.

Shqipëria përdor disa mekanizma për njohjen e kualifikimeve, si shërbimi në e-Albania për njohimin e diplomave të huaja, qendra ENIC/NARIC për informim, dhe QSHA me udhëzime dhe lista njohjesh. Për zhvillim të mëtijshëm, integrimi i mekanizmave si IMI për shkëmbim elektronik të të dhënave sjell kosto tranzicioni për sistemet IT. Këto sisteme forcojnë inovacionin dhe standardizojnë njohjen sipas standardeve të BE-së.

Në përputhje me dispozitat e Direktivës, çdo shtet anëtar ka detyrimin të krijojë një pikë kontakti (PSC), e cila vepron si qendër informacioni dhe mbështetjeje për qytetarët. Këto struktura ofrojnë udhëzim të specializuar lidhur me njohjen e kualifikimeve profesionale si dhe me kuadrin ligjor kombëtar përkatës. EPC ose “Karta Profesionale Europiane”, përshpejton procedurën e njohjes së kualifikimeve profesionale. Autoritetet kompetente shqiptare do të jenë përgjegjës për miratimin e kartave profesionale nga aplikimet e qytetarëve shqiptarë. Gjithashtu trajnimi i personelit për përdorimin efikas të sistemeve të reja, së bashku me kostot operative si përkthimet dhe verifikimet dokumentare, do të kontribuojë në përmirësimin e kapaciteteve teknike institucionale dhe në optimizimin e shpenzimeve administrative afatgjata.

Si në tabelën e paraqitur në vijim, ne kemi listuar (i) ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në terma të kostove dhe përfitimeve lidhur me qeverinë dhe autoritetet publike, (ii) shpeshtësinë e tyre (një herë apo përsëriten), (iii) të dhënat e nevojshme për përcaktimin e vlerës së kostove dhe përfitimeve, dhe (iv) burimin e informacionit nga mund të gjenden të dhënat e besueshme:

Vlerësimi i ndikimit të drejtpërdrejtë | Qeveria dhe autoritetet publike

#	Njësia	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Grup i caktuar për ndryshimin e kurrikulës	Analiza e vlerësimit të hendeut mes kurrikulave ekzistuese dhe atyre të parashikuara në Direktivë	Qartësim i hapave pasardhës për përafrimin me Direktivën	Një herë	- Orët dhe vitet aktuale të programeve të studimit - Orët dhe vitet që parashikon Direktiva - Përmbajtja e kurrikulave ekzistuese dhe njohuritë shtesë sipas Direktivës	- MA - AKAFPK
2		Përditësimi i kurrikulave mësimore	Rritja e tarifave për librat e modernizuar	Një herë	-Kurrikulat aktuale -Numrin e kurrikulave planifikuar për ndryshim	- MA - ASCAL - INSTAT - AKAFPK

3		Personeli i nevojshëm për përshtatjen e kurrikulës	Shmangia e kostove që lidhet me njohjen e vazhdueshme të kualifikimeve	Një herë	-Numri i personelit të nevojshëm -Përqindjet e parashikuara të rritjes sipas buxhetit	- MA - AKAFPK - MF - MEI
4	Grupi i caktuar për digjitalizimin	Kostot për ngritjen e strukturave për implementimin e EPC, IMI dhe PSC në Shqipëri	Standardizimi i procesit të njohjes së kualifikimeve sipas BE	Një herë	-Numri i personave të strukturës -Koha totale e zhvillimit të shërbimeve	- MA - INSTAT - PSC - e- Albania - Your Europa (EPC) - European Comission (IMI)
5		Kosto tranzicioni mbi ndryshimin e shërbimit të njësimit të diplomave në e-Albania për aksesimin e EPC, IMI dhe PSC	Reduktimi i kostove administrative	Një herë	-Identifikimi i pajisjeve të reja teknologjike -Testimet dhe sigurimi i cilësisë -Numri i personelit të angazhua -Koha totale e zhvillimit të shërbimeve -Kostot e sigurimit të të dhënave sipas GDPR	- MA - INSTAT - PSC - e- Albania - MFE - Your Europa (EPC) - European Comission (IMI)
6		Trajnim i stafit për përdorimin e sistemeve të reja	Rritje e aftësive teknike mbi sistemet e IT-së	Përsëritet sipas nevojës	-Numri i stafit që do të trajnohet -Materialet e nevojshme për trajnime -Programet aktuale të trajnimit -Kapacitetet teknike të institucioneve	- Ministritë përkatëse - INSTAT - ASPA
7	Ministritë	Kosto operacionale për përkthimet e nevojshme dhe verifikime	Rritje e cilësisë së shërbimeve administrative	Përsëritet	-Kapacitetet teknike të institucioneve	- Ministritë përkatëse - ASPA

		dokumentash				
8		Kostot e trajnimeve pilot për testimin e efektivitetit të programeve trajnuese	Vlerësimi paraprak i zhvillimeve përpara testeve internacionale si testi i proporcionalitetit	Një herë	-Numri i pjesëmarrësve në trajnimet pilot -Numri i sesioneve që do të zhvillohen -Personeli i përfshirë në organizim dhe mbikëqyrje -Përpunimi dhe raportimi i rezultateve	- Ministritë përkatëse - ASPA
9		Kosto për konsulencë ligjore	Reduktimi i rreziqeve ligjore dhe përputhshmëri me ligjet	Një herë	-Identifikimi i çështjeve për të cilat nevojitet konsulencë -Numri i konsulentëve	- Ministritë përkatëse

Vlerësimi i ndikimit të tërthortë | Qeveria dhe autoritetet publike

#	Njësia	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Grup i caktuar për ndryshimin e kurrikulës	Nevoja për konsulencë shtesë nga profesionistë të BE-së	Përsheptimi i procesit të përditësimit të kurrikulave	Përsëritet sipas nevojës	- Orët dhe vitet aktuale të programeve të studimit - Orët dhe vitet që parashikon Direktiva - Përmbajtja e kurrikulave ekzistuese dhe njohuritë shtesë sipas Direktivës	-MA -ASCAL
2		Kostot e monitorimi gjatë përditësimit të kurrikulës	Përfitim nga taksat (TVSH) mbi materialet e reja të kurrikulave të përditësuara	Një herë	-Tarifa e kurrikulave të reja - Numri i personave që do të ngarkohen me monitorim	-MA -ASCAL
3		Materialet dhe teknologjia e	Përshtatje e programit arsimor me	Një herë	-Numri i personelit të nevojshëm -Përqindjet e	-MA -AKAFPK

		nevojshme për trajnime	kërkesat e tregut		parashikuara të rritjes sipas buxhetit	-ASPA -MF -MEI
4	Grupi i caktuar për digjitalizimin	Kosto në terma kohor për arritjen e bashkëpunimi ndërinstitucional	Rritja e potencialit inovativ në vend	Një herë	-Numri i personave të strukturës -Koha totale e zhvillimit të shërbimeve	-MA -INSTAT -PSC -e-Albania -MF -MEI -Your Europa (EPC) -European Comission (IMI)
5		Kosto e informimit të institucioneve dhe qytetarëve mbi përdorimin e tyre	Integrim në tregun e përbashkët evropian	Një herë	-Identifikimi i pajisjeve të reja teknologjike -Numri i personelit të angazhuar -Koha totale e zhvillimit të shërbimeve	-Ministritë përkatëse -INSTAT -e-Albania -Your Europa (EPC) -European Comission (IMI)
6		Implementimi i sistemeve të sigurisë së të dhënave sipas GDPR	Rritje e efikasitetit institucional	Një herë	-Kostot e sigurimit të të dhënave sipas GDPR -Kosto të shërbimeve të IT nga institucione qeveritare ose private	-INSTAT -Ministritë përkatëse -GDPR
7	Ministritë	Përshtatja e infrastrukturës së nevojshme për të mundësuar trajnimin	Ulje e kostove administrative në kohë afatgjatë	Përsëritet	-Numri i stafit që do të trajnohet -Materialet e nevojshme për trajnime -Programet aktuale të trajnimit -Kapacitetet teknike të institucioneve	-Ministritë përkatëse -INSTAT -ASPA

8		Trajnime për stafin administrativ për thjeshtëzimin e procedurave administrative	Përmirësim i bashkëpunimit me institucionet e BE-së	Përsëritet	-Numri i punonjësve në akademi dhe administratë -Kapacitetet teknike të institucioneve	-Ministritë përkatëse -ASP
9		Koordinimi midis institucioneve për realizimin në kohë të trajnimeve	Përmirësim i programeve bazuar në feedback dhe rezultate	Një herë	-Numri i pjesëmarrësve në trajnimet pilot -Numri i sesioneve që do të zhvillohen -Personeli i përfshirë në organizim dhe mbikëqyrje -Përpunimi dhe raportimi i rezultateve	-Ministritë përkatëse -ASP
10		Investim i burimeve teknike dhe kohës për zhvillim	Rritje e kapaciteteve teknologjike institucionale	Përsëritet	-Identifikimi i sistemeve egzistuese -Numri i punonjësve të angazhuar	-Ministritë përkatëse
11		Koordinim dhe menaxhim i bashkëpunimit me konsulentët ligjorë	Përmirësim i reputacionit për zbatim të ligjit	Një herë	-Identifikimi i çështjeve për të cilat nevojitet konsulentë -Numri i konsulentëve	-Ministritë përkatëse

Për shkak të mungesës së informacionit dhe pamundësisë së analizave konkrete për vlerësimin sasior të kostove apo përfitimeve të identifikuar, matrica e kosto-përfitimit mbetet e pa-kuantifikuar. Megjithatë, duke konsideruar të dhënat e specifikuar me referencë burimet e besueshme të informacionit nga ku mund të merren këto të dhëna, mund të përllogaritet një vlerësim sasior i kostove dhe përfitimeve për këtë grup.

Duke qenë se zbatimi i Direktivës pritet të ketë ndikime në politikat fiskale dhe monetare, rregullat tregtare, PBB, investime dhe konsum, për të përllogaritur mbulimin e efekteve makroekonomike, do të sugjerohej ndërtimi i një modeli financiar me analiza sensitiviteti dhe skenarë të ndryshëm si modele CGE, analiza input - output, dhe modele të tjera simuluese në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe INSTAT, për të matur ndikimin në PBB si dhe punësim dhe eksport shërbimesh.

Matrica e sugjeruar me kostot dhe përfitimet nga implementimi i Direktivës, mund të hasin në sfida si: kompleksiteti i kuadrit ligjor dhe mungesa e ekspertizës së brendshme, përbën një faktor rreziku me ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e plotë dhe koherent të dispozitave përkatëse të parashikuara në aktin rregullator të Bashkimit Europian. Nga pikëpamja institucionale, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, kapacitetet e kufizuara për organizimin e trajnimeve dhe rezistenca e mundshme ndaj ndryshimeve, përbëjnë barriera të cilat mund të ndikojnë në efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e implementimit të Direktivës. Financimi i përgjithshëm për implementimin e Direktivës, synohet të realizohet përmes rialokimit të buxhetit të institucioneve qeveritare, të cilat përcaktohen nga buxheti i shtetit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë publikon alokimin e buxheteve në Ministritë përkatëse. Në rast të papërbalueshmërisë buxhetore, qeveria mund të kërkojë burime financimi nga BE ose IPA III.

Kosto administrative: Ndryshimet ligjore do të shoqërohen me kosto administrative, veçanërisht për institucionet publike që janë përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të ri rregullator. Këto kosto përfshijnë nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv dhe të qëndrueshëm të testit të proporcionalitetit, përfshirë zhvillimin e metodologjive vlerësuese, trajnimin e stafit dhe ngritjen e mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional. Matja e këtyre kostove kërkon të dhëna aktuale mbi proceset administrative, burimet njerëzore dhe alokimet buxhetore brenda institucioneve përkatëse, si dhe parashikime për investime shtesë që kërkohen për përmbushjen e këtyre përgjegjësi.

Institucionet e arsimit të lartë

Implementimi i kërkesave të Direktivës parashikohet të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në Institucioneve të Arsimit të Lartë, duke nisur nga ndryshimi i kurrikulave sipas standardeve të përcaktuara në rregullatorët e Direktivës dhe detyrimeve të përcaktuara në VKM nr. 41/2018. Programet aktuale të ofruara nga këto institucione nuk janë në përputhje me nivelin e arsimit të standardeve të BE-së, rrjedhimisht përditësimi i kurrikulave do të sjellë përmirësimin e imazhit dhe njohjen më të gjerë të programeve arsimore, duke i bërë kështu ato të njëvleftshme me programet të arsimit të lartë në vendet e BE-së. Si pasojë, pritet një interes më i madh nga studentët e huaj për ndjekjen e programeve të studimit në Shqipëri si dhe rritjen e numrit të studentëve shqiptarë të cilët preferojnë të ndjekin studimet në vend. Gjithashtu përafrimi i kësaj Direktive, do të luajë një rol në politikën arsimore për fuqizimin e barazisë gjinore, duke sjellë një përfaqësim më të gjerë të gjinive të nën-përfaqësuar në degët përkatëse.

Si në tabelën e paraqitur në vijim, ne kemi listuar (i) ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në terma të kostove dhe përfitimeve lidhur me qeverinë dhe autoritetet publike, (ii) shpeshtësinë e tyre (një herë apo përsëriten), (iii) të dhënat e nevojshme për përcaktimin e vlerës së kostove dhe përfitimeve, dhe (iv) burimin e informacionit nga mund të gjenden të dhënat e besueshme:

Vlerësimi i ndikimit të drejtpërdrejtë | Institucionet e Arsimit të Lartë

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Kosto për akreditimin e plotë të universiteteve	Rritja e numrit të studentëve vendas dhe të huaj	Përsëritet çdo 5 vite	-Numri i universiteteve të akredituar/joakredituar -Kriteret e nevojshme për akreditim	-ASCAL -INSTAT -IAL -EUA -ACEEU
2	Akreditim i programeve të paakredituara	Zhvillimi i sektorëve të rinj në arsim dhe në tregun e punës	Një herë	-Numri i programeve universitare të akredituara/paakredituara -Kriteret e nevojshme për akreditim	-ASCAL -INSTAT -IAL
3	Digjitalizimi i sistemeve ekzistuese ose zhvillimi i mëtejshëm i tyre	Mbyllja e hendekut të marrjes së shërbimeve midis zonave rurale dhe urbane	Një herë	-Identifikimi i kapacitetit të sistemeve ekzistuese -Numri i punonjësve të angazhuar	-ASCAL -IAL

4	Rritja e kapaciteteve infrastrukturore të ambienteve dhe laboratorëve	Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimeve shkencore	Një herë	-Identifikimi i kapaciteteve teknike aktuale -Numri i punonjësve të angazhuar	-IAL
5	Trajnimi i stafit akademik dhe administrativ	Përmirësim i proceseve dhe zbatimit të politikave	Përsëritet	-Numri i personelit të nevojshëm -Përqindjet e parashikuara të rritjes sipas buxhetit	-IAL -AKAFPK
6	Konsulencë ligjore	Ulja e kostove për administratën në kohë afatgjatë	Një herë	-Identifikimi i çështjeve për të cilat nevojitet konsulencë -Numri i konsulentëve	-IAL -MA
7	Kostot e certifikatës e përputhshmërisë për profesionet e parregulluara në Shqipëri	Mundësia e ofrimit të shërbimeve së profesionistëve drejt vendeve të BE-së	Përsëritet	-Lista e profesioneve të parregulluara nga Direktiva në Shqipëri -Lista e dokumenteve të nevojshme për aplikim	-MA -Urdhrat Profesionalë

Vlerësimi i ndikimit të tërthortë | Institucionet e Arsimit të Lartë

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Rritja e fenomenit të largimit të trurit(brain drain)	Nxitja e projekteve të bashkëpunimit midis institucioneve vendase dhe atyre ndërkombëtare	Përsëritet çdo 5 vite	-Flukset e emigrimit profesional	-ASCAL -INSTAT -IAL
2	Monitorimi i ndryshimeve administrative dhe akademike	Fuqizim i pozitës konkurruese ndaj institucioneve të huaja	Një herë	-Numri i personave të ngarkuar për monitorim	-ASCAL -INSTAT -IAL
3	Kosto për migrimin e të dhënave dhe	Reduktim i rrezikut të	Një herë	-Identifikimi i kapacitetit të sistemeve ekzistuese	-ASCAL -IAL

	mirëmbajtjen teknike	humbjes së të dhënave		-Numri i punonjësve të angazhuar	
4	Nevoja për menaxhim të projekteve ndërtimore ose rinovuese	Nxitje e bashkëpunimeve shkencore dhe kërkimore	Një herë	-Identifikimi i kapaciteteve teknike aktuale -Numri i punonjësve të angazhuar	-IAL
5	Ulje e efikasitetit në operacionet e përditshme	Përmirësim i imazhit profesional për institucionet	Përsëritet	-Numri i personelit të nevojshëm	-IAL -AKAFPK
6	Koordinim për përfshirjen e konsulentëve në procese të ndryshme	Rritja e transparencës dhe besueshmërisë institucionale	Një herë	-Identifikimi i çështjeve për të cilat nevojitet konsulencë -Numri i konsulentëve	-IAL -MA

Për identifikimin e kostove dhe përfitimeve të Institucioneve të Arsimit të Lartë, ne kemi shqyrtuar modele krahasimore ndërkombëtare të vendeve që kanë kaluar në një tranzicion të ngjashëm me Shqipërinë, si Kroacia dhe Rumania.

Për shkak të mungesës së informacionit dhe pamundësisë së analizave konkrete për vlerësimin sasior të kostove apo përfitimeve të identifikuar, matrica e kosto-përfitimit mbetet e pa-kuantifikuar. Megjithatë, duke konsideruar të dhënat e specifikuar me referencë burimet e besueshme të informacionit nga ku mund të merren këto të dhëna, mund të përlogaritet një vlerësim sasior e kostove dhe përfitimeve për këtë grup.

Matrica e sugjeruar me kostot dhe përfitimet nga implementimi i Direktivës, mund të hasin në sfida si: vështirësi e koordinimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, vonesa në përmbushjen e trajnimeve apo udhëzimeve të nevojshme për implementim, rezistenca ndaj ndryshimeve dhe vështirësitë teknike në përshtatjen e sistemeve ekzistuese me sistemet sipas standardeve të BE-së

Urdhrrat Profesionalë

Përshtatja e veprimtarive të Urdhrave Profesionalë me qëllim transpozimin e plotë të Direktivës, do të eliminojë pengesat e ushtrimit të profesioneve të rregullta, duke lehtësuar kështu procedurat e nevojshme. Procedurat aktuale të njohjes së profesioneve zhvillohen nëpërmjet bazave të fragmentuara dhe mekanizmave të veçanta, të pa standardizuara. Me ndryshimet teknike dhe administrative do të bëhet i mundur harmonizimi i këtyre procedurave, duke eliminuar pasiguritë ligjore, rrezikun e subjektivitetit dhe mungesën e udhëzimeve konkrete për njohjen e kualifikimeve. Linjëzimi i proceseve të njohjes së kualifikimeve të Urdhrave Profesionalë me *acquis communautaire* dhe praktikave të BE-së do të sillte qasje më të gjerë në tregje të reja pune, rritje të mobilitetit profesional dhe kapacitetin administrativ e teknik të këtyre institucioneve.

Zhvillimi i pikave të mësipërme do të bënte të mundur përfshirjen e Urdhrave Profesionalë në rrjetin e bashkëpunimit evropian, duke mundësuar shkëmbimin e praktikave dhe përvojave më të mira rregullatore. Implementimi dhe përdorimi i sistemeve IMI dhe EPC sjell gjithashtu përgjegjësi të reja, si lëshimin e certifikatave dhe dëshmimeve për njohjen e kualifikimeve. Njëkohësisht, me ndryshimet e mësipërme, pritet një bashkërendim më i ngushtë midis Urdhrave Profesionalë dhe administratës.

Si në tabelën e paraqitur në vijim, ne kemi listuar (i) ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në terma të kostove dhe përfitimeve lidhur me qeverinë dhe autoritetet publike, (ii) shpeshtësinë e tyre (një herë apo përsëriten), (iii) të dhënat e nevojshme për përcaktimin e vlerës së kostove dhe përfitimeve, dhe (iv) burimin e informacionit nga mund të gjenden të dhënat e besueshme:

Vlerësimi i ndikimit të drejtpërdrejtë | Urdhrat Profesionale

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Përditësimi i proceseve për pranimin e Kartave Profesionale Evropiane (EPC)	Nxitje e mobilitetit profesional	Një herë	-Lista e numrit të profesionistëve të parashikuar brenda kriterëve të EPC-së -Identifikimi i proceseve të nevojshme për përditësim	-Your Europa (EPC) -Urdhrat Profesionale -MA
2	Përditësimi i proceseve për pranimin e profesionistëve	Rritje e efikasitetit të punës së urdhrave profesionale	Një herë	-Identifikimi i proceseve aktuale -Numri i punonjësve të angazhuar	-MA -Urdhrat profesionale
3	Trajnime dhe certifikime të stafit	Sigurim i certifikimeve që përmbushin standardet kombëtare/ndërkombëtare	Përsëritet	-Numri i personelit të nevojshëm -Përqindjet e parashikuara të rritjes sipas buxhetit	-Urdhrat profesionale -AKAFPK
4	Monitorimet për zbatimin dhe përputhshmërinë e ligjit	Ndihmon në evidentimin dhe adresimin e shkeljeve të ligjit	Përsëritet	-Numri i punonjësve të angazhuar -Intervalet kohore të testimit të shërbimeve	-Urdhrat profesionale -MA

Vlerësimi i ndikimit të tërthortë | Urdhrat Profesionale

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Adaptimi i strukturave të vjetra me kërkesat e reja	Përmirësim i efikasitetit në shqyrtimin e aplikimeve ndërkombëtare	Një herë	-Lista e numrit të profesionistëve të parashikuar brenda kriterëve të EPC-së -Identifikimi i proceseve të nevojshme për përditësim	-Your Europa (EPC) -Urdhrat Profesionale -MA
2	Rritje e fenomenit të largimit të trurit/emigrimit profesional (brain drain)	Rritje e bashkëpunimit me homologët e BE-së	Një herë	-Flukset e emigrimit profesional	-INSTAT -MA -Urdhrat profesionale
3	Ngarkesë administrative shtesë	Rritje e cilësisë së mbikëqyrjes institucionale	Përsëritet	-Numri i punonjësve të angazhuar -Intervalet kohore të testimit të shërbimeve	-Urdhrat profesionale -MA

Metodologjia e përdorur për identifikimin e kostove dhe përfitimeve për Urdhrat Profesional, bazohet në një rishikim të raporteve dhe analizave të publikuara nga Institucionet e Urdhrave Profesionalë, si dhe modele krahasimore ndërkombëtare të vendeve që kanë kaluar në një tranzicion të ngjashëm me Shqipërinë, si Kroacia dhe Rumania.

Për shkak të mungesës së informacionit dhe pamundësisë së analizave konkrete për vlerësimin sasior të kostove apo përfitimeve të identifikuar, matrica e kosto-përfitimit mbetet e pa-kuantifikuar. Megjithatë, duke konsideruar të dhënat e specifikuar me referencë burimet e besueshme të informacionit nga ku mund të merren këto të dhëna, mund të përlllogaritet një vlerësim sasior e kostove dhe përfitimeve për këtë grup.

Matrica e sugjeruar me kostot dhe përfitimet nga implementimi i Direktivës, mund të hasin në sfida si: mungesa e koordinimit midis institucioneve, mangësitë në kapacitete administrative dhe kompleksitet në harmonizimin ligjor të Direktivës. Gjithashtu ekspertiza e pamjaftueshme e stafit mund të sjellë vonesa në trajnime apo vështirësi në adaptimin e ndryshimeve administrative dhe digjitale.

Studentët dhe profesionistët e ardhshëm të kualifikuar

Me përafrimin e programeve të studimit dhe formimit profesional sipas standardeve të BE-së, studentët përfitojnë mundësi më të mira punësimi drejt vendeve të BE-së duke lehtësuar njohjen e kualifikimeve të kryera në Shqipëri, duke sjellë një ndikim të tërthortë në inkurajimin e ndjekjes së studimeve në profesionet e rregulluara në Shqipëri. Një tjetër ndikim parashikohet të jetë lëvizja e anasjelltë e studentëve të huaj për të kryer studimet e arsimit të lartë në Shqipëri, si pasojë e tarifave të studimit më konkurruese krahasuar me vendin e origjinës.

Si në tabelën e paraqitur në vijim, ne kemi listuar (i) ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në terma të kostove dhe përfitimeve lidhur me qeverinë dhe autoritetet publike, (ii) shpeshtësinë e tyre (një herë apo përsëriten), (iii) të dhënat e nevojshme për përcaktimin e vlerës së kostove dhe përfitimeve, dhe (iv) burimin e informacionit nga mund të gjenden të dhënat e besueshme:

Vlerësimi i ndikimit të drejtpërdrejtë | Studentët dhe profesionistët e ardhshëm të kualifikuar

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Tarifa per regjistrime në urdhërat profesionale	Njohje e kualifikimeve automatikisht, pa nevojën e provimeve shtesë	Një herë	-Tarifat e regjistrimeve në urdhërat profesional	-MA -QSHA -KSHK
2	Zgjatja kohore e programeve studimore në varësi të orëve të kërkuara per cdo profesionit duke vonuar hyrjen në tregun e punës	Kompensime financiare më të larta, si pasojë e kualifikimit sipas standarteve europiane	Një herë	-Orët e trajnimeve sipas programeve të studimeve që do të preken nga Direktiva	-IAL

3		Cilësi më të lartë të edukimit dhe përgatitjes profesionale	Një herë	-Lista e zyrave të këshillimit të karrierës	-MA -QSHA -KSHK
4		Përfitime në marrjen e njohurive më të zgjeruar nga profesionistët vendas dhe të huaj, me kurikula akademike të rregulluara	Një herë	-Tarifat e librave sipas programeve mësimore	-MA -QSHA -KSHK
5		Akses më i shpejtë dhe i lehtë në procedurat e aplikimit online për njohjen e kualifikimeve	Një herë	-Lista e zyrave të këshillimit të karrierës	-INSTAT -IAL

Vlerësimi i ndikimit të tërthortë | Studentët dhe profesionistët e ardhshëm të kualifikuar

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Tarifa me të larta për librat shkollor dhe artikujt e studimit	Lehtësi në mënyrën e aplikimeve në profesionet e rregulluara në tregun e BE-së	Përsëritet	-Tarifat e librave sipas programeve mësimore	-MA -QSHA -KSHK
2	Rritje e tarifave vjetore studimore.	Zgjedhje e studentëve për të vazhduar studimet në Shqipëri me kurrikulat e reja kundrejt ikjes në shtete të tjera	Përsëritet	-Tarifat e studimeve sipas degëve	-MA -QSHA -KSHK

3	Kosto shtesë të mobilitetit për studentët në vendin e origjinës	Tarifa favorizuese për studentë të huaj, në varësi të nivelit të jetesës	Përsëritet	-Tarifat e studimeve sipas degëve	-MA -QSHA -KSHK
4		Rritja e mundësive për të zhvilluar profesionin në vendet e BE-së, duke lehtësuar njohjen e kualifikimeve të fituara	Përsëritet	-Lista e zyrave të këshillimit të karrierës	-IAL
5		Përmirësim i aftësive dixhitale dhe rritje e konkurrueshmërisë në tregun e punës	Një herë	-Lista e zyrave të këshillimit të karrierës	-INSTAT -IAL

Për identifikimin e kostove dhe përfitimeve të studentët dhe profesionistët e ardhshëm të kualifikuar, ne kemi shqyrtuar modele krahasimore ndërkombëtare të vendeve që kanë kaluar në një tranzicion të ngjashëm me Shqipërinë, si Kroacia dhe Rumania.

Për shkak të mungesës së informacionit dhe pamundësisë së analizave konkrete për vlerësimin sasior të kostove apo përfitimeve të identifikuar, matrica e kosto-përfitimit mbetet e pa-kuantifikuar. Megjithatë, duke konsideruar të dhënat e specifikuar me referencë burimet e besueshme të informacionit nga ku mund të merren këto të dhëna, mund të përlllogaritet një vlerësim sasior e kostove dhe përfitimeve për këtë grup.

Matrica e sugjeruar me kostot dhe përfitimet nga implementimi i Direktivës, mund të hasin në sfida si: koha për dorëzimin dhe pranimin e dokumentacionit për përfitimin e kartave digjitale (Karta Europiane e Profesionit), përdorimi i risive teknologjike për njohjen e kualifikimeve dhe përshtatja me kurrikulat e reja.

Profesionistët

Një tjetër grup i ndikuar nga implementimi i Direktivës do të jenë dhe profesionistët aktual të kualifikuar të cilët do të kenë lehtësime të drejtpërdrejta në lëvizjen e ndërsjellë në tregun e punës drejt vendeve të BE-së dhe anasjelltas. Rritja e një tregu pune konkurrues, si rrjedhojë e profesionistëve vendas dhe të huaj, pritët të nxisë ofrimin e shërbimeve me cilësi më të lartë dhe të inkurajojë zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Me implementimin e Direktivës parashikohet që një pjesë e profesionistëve të shohin mundësi për të ushtruar profesionin në vende të tjera të BE-së, si pasojë e kushteve më të mira të punës si dhe nga përfitime më të mira financiare. Për tregun vendas kjo dinamikë parashikohet të sjellë një shtysë pozitive duke nxitur tregun vendas që të përmirësojë kushtet e punës dhe të sistemit të shpërbërimit për arsye të ruajtjes dhe tërheqjes së profesionistëve të kualifikuar.

Si në tabelën e paraqitur në vijim, ne kemi listuar (i) ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në terma të kostove dhe përfitimeve lidhur me qeverinë dhe autoritetet publike, (ii) shpeshtësinë e tyre (një herë apo përsëriten), (iii) të dhënat e nevojshme për përcaktimin e vlerës së kostove dhe përfitimeve, dhe (iv) burimin e informacionit nga mund të gjenden të dhënat e besueshme:

Vlerësimi i ndikimit të drejtpërdrejtë | Profesionistët

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Tarifat e specializimeve shtesë	Përmirësim dhe përvetësim i aftësive profesionale përmes praktikave në BE	Një herë	- Lista e specializimeve shtesë sipas profesioneve sektoriale; - Tarifat e specializimit	-MA, -CEDEFOP
2	Kostot e përkthimeve dhe noterizimeve të dokumentave	Rritje e remitançave nëse profesionistët shpërngulen në vendet pritëse	Një herë	-Tarifat për përkthim dhe noterizim	-Kërkim tregu pranë zyrave të noteriale
3	Tarifa për vizën dhe lejen e qëndrimit sipas vendit pritës	Ulje e kohës së pritjes për punësim nga disa muaj në disa javë	Një herë	-Tarifa e vizës dhe lejes së qëndrimit	-Ambasadat dhe konsullatat
4	Shpenzime mobiliteti në vendin pritës		Një herë	-Kostot e jetesës në vendin pritës	-Kërkim tregu sipas standardeve të vendit pritës
5	Tarifat për kursin e gjuhës së vendit pritës		Një herë	-Tarifat e studimit të gjuhëve të huaja	-Qendra kursesh si Goethe -CEDEFOP

Vlerësimi i ndikimit të tërthortë | Profesionistët

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Përshtatje me zhvillimet e reja teknologjike (digjitalizimi)	Rritja e mundësive për zhvillimin e kërkimeve shkencore mes profesionistëve të BE-së me ata të Shqipërisë	Përsëritet	-Anketime -Analiza dhe raporte	-INSTAT -Erasmus +

2		Përmirësimi i kushteve të punës dhe i sistemit të shpërblimit në Shqipëri	Përsëritet	-Anketime -Analiza dhe raporte	-INSTAT
3		Rritje e tregut konkurrues në vend dhe në BE	Përsëritet	-Anketime -Analiza dhe raporte	-INSTAT -AKPA -CEDEFOP

Për identifikimin e kostove dhe përfitimeve të profesionistëve, ne kemi shqyrtuar modele krahasimore ndërkombëtare të vendeve që kanë kaluar në një tranzicion të ngjashëm me Shqipërinë, si Kroacia dhe Rumania.

Për shkak të mungesës së informacionit dhe pamundësisë së analizave konkrete për vlerësimin sasior të kostove apo përfitimeve të identifikuara, matrica e kosto-përfitimit mbetet e pa-kuantifikuar. Megjithatë, duke konsideruar të dhënat e specifikuar me referencë burimet e besueshme të informacionit nga ku mund të merren këto të dhëna, mund të përlogaritet një vlerësim sasior e kostove dhe përfitimeve për këtë grup.

Matrica e sugjeruar me kostot dhe përfitimet nga implementimi i Direktivës, mund të hasin sfida kryesisht në barrierat gjuhësore dhe ato kulturore si për profesionistët e huaj të kualifikuar që do të ushtrojnë profesionin e tyre në Shqipëri si dhe anasjelltas, për profesionistët e kualifikuar shqiptarë që preferojnë të ushtrojnë profesionin e tyre në vendet e BE-së.

Bizneset

Zbatimi i Direktivës do të mundësojë një numër më të madh profesionistësh të kualifikuar për punëdhënësit dhe bizneset duke i bërë ata më të ndjeshëm ndaj rishikimit të praktikave të rekrutimit, uljen e kostove të këtij procesi dhe rritjen e efikasitetit, nxitje të inovacionit dhe konkurrueshmërisë.

Si në tabelën e paraqitur në vijim, ne kemi listuar (i) ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në terma të kostove dhe përfitimeve lidhur me qeverinë dhe autoritetet publike, (ii) shpeshtësinë e tyre (një herë apo përsëriten), (iii) të dhënat e nevojshme për përcaktimin e vlerës së kostove dhe përfitimeve, dhe (iv) burimin e informacionit nga mund të gjenden të dhënat e besueshme:

Vlerësimi i ndikimit të drejtpërdrejtë | Bizneset

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Kosto për trajnime dhe zhvillime të burimeve njerëzore	Rritja e aksesit të profesionistëve në një gamë më të gjerë kompetencash, aftësish dhe ekspertizash	Përsëritet	- Lista e specializimeve shtesë sipas profesioneve sektoriale; - Tarifat e specializimit	-MA, CEDEFOP

2	Rritje e kompensimit për profesionistët, për shmangien e largimit të stafit të kualifikuar nga vendi i origjinës	Rritje e profesionistëve të kualifikuar në vend	Përsëritet	- Kompensimet e profesionistëve sipas tregut të punës dhe koeficienti rritës i tyre	-Kërkim tregu -INSTAT
3	Prirja e individëve me kualifikime të larta të zgjedhin mundësi punësimi në vende të tjera të BE-së: largimi i trurit	Lëvizja e anasjelltë e profesionistëve nga vendet e BE-së drejt Shqipërisë	Përsëritet	-Numri i emigrimit të profesionistëve të fushave të caktuara	-INSTAT
4	Kostot për inovacion (instalimi i sistemeve të digjitalizuara)	Reduktim në kosto dhe në kohëzgjatjen e procedurave të rekrutimit	Përsëritet	-Kostot e instalimit të sistemeve	-Kërkim tregu pranë kompanive software
5	Kostot për sondazhet e ndërmarra nga bizneset në ndikimin e hyrjes dhe daljeve të profesionistëve pas implementimit të Direktivës	Hartim i politikës për kundërpërgjigje ndaj fenomenit të largimit të trurit	Një herë	- Profesionet me lëvizjet e ndërsjellëta më të shpeshta - Listë me pyetje për sondazhin	-Kërkim tregu -INSTAT

Vlerësimi i ndikimit të tërthortë | Bizneset

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Pasiguri në planifikimin financiar të biznesit për shkak të	Pozicionim konkurrues në treg si biznes me standarde të BE-së duke	Përsëritet	- Profesionet me lëvizjet e ndërsjellëta më të shpeshta - Listë me pyetje për sondazhin	-Kërkim tregu -INSTAT

	dinamikave të tregut të punës në BE	fituar dhe besimin e palëve të treta (turizmit mjekësor)			
2	Pozicione pune dhe procese rekrutimi të hapura		Përsëritet	- Kompensimet e profesionistëve sipas tregut të punës dhe koeficienti rritës i tyre	-Kerkim tregu -INSTAT
3	Koha e pritjes për instalimin e pajisjeve		Përsëritet	-Kostot e instalimit të sistemeve	-Kerkim tregu -INSTAT

Për shkak të mungesës së informacionit dhe pamundësisë së analizave konkrete për vlerësimin sasior të kostove apo përfitimeve të identifikuara, matrica e kosto-përfitimit mbetet e pa-kuantifikuar. Megjithatë, duke konsideruar të dhënat e specifikuar me referencë burimet e besueshme të informacionit nga ku mund të merren këto të dhëna, mund të përlllogaritet një vlerësim sasior e kostove dhe përfitimeve për këtë grup.

Matrica e sugjeruar me kostot dhe përfitimet nga implementimi i Direktivës, mund të hasin në sfida si: mungesa të përkohshme në fuqinë punëtore, për shkak të lëvizjes së profesionistëve aktualë drejt tregjeve të huaja, të nxitur nga kushte më të favorshme pune dhe shpërblime më të larta financiare.

Qytetarët

Përfituesit kryesorë të shërbimeve profesionale nga implementimi i kësaj Direktive janë qytetarët të cilët përfitojnë një rritje të cilësisë së shërbimeve të ofruara nga profesionistët e kualifikuar. Por nga ana tjetër parashikohet që qytetarët në një kohë të shkurtër mund të përballen me një mungesë të përkohshme të profesionistëve në fusha të caktuara për shkak të fenomenit të largimit të trurit.

Si në tabelën e paraqitur në vijim, ne kemi listuar (i) ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në terma të kostove dhe përfitimeve lidhur me qeverinë dhe autoritetet publike, (ii) shpeshtësinë e tyre (një herë apo përsëriten), (iii) të dhënat e nevojshme për përcaktimin e vlerës së kostove dhe përfitimeve, dhe (iv) burimin e informacionit nga mund të gjenden të dhënat e besueshme:

Vlerësimi i ndikimit të drejtpërdrejtë | Qytetarët

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Rritje e çmimeve në shërbimet shëndetësore dhe profesionale për shkak të mungesës së stafit (largimi i trurit) dhe rritjes së kërkesës	Përmirësim i cilësisë së shërbimeve në rastet kur profesionistët e kualifikuar kthehen në Shqipëri me përvojë nga BE	Përsëritet	- Tarifat e shërbimeve shëndetësore - Normat e rritjes së tarifave përgjatë viteve të fundit	-INSTAT

2	Një rënie e shërbimit të cilësisë në zonat rurale, për shkak të lëvizjes së profesionistëve drejt zonave urbane	Rritje e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe profesionale	Një herë	-Pyetësor për cilësinë e shërbimit shëndetësor ose profesional	-Anketime
---	---	---	----------	--	-----------

Vlerësimi i ndikimit të tërthortë | Qytetarët

#	Kostot	Përfitimet	Shpeshtësia	Të dhënat	Burimi i të dhënave
1	Humbje e aksesit në shërbime publike cilësore, për shkak të largimit të profesionistëve të kualifikuar drejt BE-së	Rritje e remitancave nga profesionistët që punojnë në BE, duke përmirësuar mirëqenien e familjeve	Përsëritet	-Pyetësor për cilësinë e shërbimit shëndetësor ose profesional	-INSTAT -Anketime

Për shkak të mungesës së informacionit dhe pamundësisë së analizave konkrete për vlerësimin sasior të kostove apo përfitimeve të identifikuara, matrica e kosto-përfitimit mbetet e pa-kuantifikuar. Megjithatë, duke konsideruar të dhënat e specifikuar me referencë burimet e besueshme të informacionit nga ku mund të merren këto të dhëna, mund të përllogaritet një vlerësim sasior e kostove dhe përfitimeve për këtë grup.

Matrica e sugjeruar me kostot dhe përfitimet nga implementimi i Direktivës, mund të hasin në sfida si largimi i trurit duke qenë se profesionistët e kualifikuar mund të preferojnë të ushtrojnë profesionin e tyre në vendet e BE-së, duke bërë që qytetarët të përballen me një rritje të lehtë të çmimeve ose një kosto të kohës në pritje të marrjes së shërbimeve të nevojshme.

Vlerësimi i përgjithshëm dhe rëndësia e të dhënave:

Kosto dhe përfitime: Zbatimi i Direktivave paraqet si kosto, ashtu edhe përfitime. Kosto afatshkurtra parashikohen për qeverinë, bizneset dhe potencialisht qytetarët. Një analizë gjithëpërfshirëse kosto-përfitim varet në masë të madhe nga disponueshmëria e të dhënave të sakta dhe të përditësuara për të matur si kostot, ashtu edhe përfitimet për secilën palë të interesuar. Siç dhe përmendet mësipër mungesa e informacionit në këtë fazë nuk lejon një kuantifikim të matricës së kosto-përfitimeve.

Potencial afatgjatë: Përafrimi i Direktivave pritët të nxisin konkurrencën dhe inovacionin, duke sjellë përfitime afatgjata si rritje të të ardhurave të qeverisë, një treg më dinamik dhe përmirësime të mundshme në efikasitet dhe tregti. Për të parashikuar në mënyrë të besueshme këto efekte afatgjata, është thelbësore të disponohen të dhëna historike për të modeluar rritjen ekonomike, dinamikën e tregut dhe ndikimet e reformave të ngjashme në vende të tjera, si dhe të dhëna aktuale për të informuar projeksionet.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i zgjedhur është opsioni nr. 2 që parashikon hartimin e projektligjit “Mbi sistemet e njohjes së kualifikimeve profesionale” i cili do të përfshijë Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 për testin e proporcionalitetit.

Ky është parë si opsioni i preferuar, pasi nëpërmjet hartimit të një ligji me efekt horizontal që përfshon *acquis communautaire* në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale, do të bëhet i mundur adresimi i problematikave duke hedhur themelet për unifikimin dhe standardizimin e plotë të parashikimeve vendase për profesionet e rregulluara dhe njohjen e kualifikimeve profesionale.

Përafrimi i Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit në një ligj të vetëm, në vend të ndarjes së tyre në dy ligje të veçanta, është qasja më efikase dhe koherente për disa arsye kryesore.

Së pari, të dyja Direktivat janë të lidhura ngushtë, pasi rregullojnë të njëjtën fushë – njohjen dhe rregullimin e profesioneve të rregulluara. Direktiva 2005/36/KE përcakton rregullat për njohjen e kualifikimeve profesionale, duke mundësuar mobilitetin e profesionistëve brenda BE-së, ndërsa Direktiva (BE) 2018/958 vendos kriteret për testin e proporcionalitetit, duke garantuar që çdo kufizim mbi ushtrimin e profesioneve të rregulluara të jetë i justifikuar dhe proporcional. Duke qenë se testi i proporcionalitetit zbatohet drejtpërdrejt mbi rregullat e njohjes së kualifikimeve, është logjike që të dy Direktivat të trajtohen brenda të njëjtit ligj për të siguruar harmonizim të plotë dhe shmangien e konflikteve ligjore.

Së dyti, një ligj i vetëm siguron një kuadër të qartë dhe të strukturuar për institucionet përgjegjëse, duke shmangur burokracinë dhe mbivendosjen e përgjegjësisë. Ministritë dhe institucionet që do të zbatojnë rregullat e njohjes së kualifikimeve dhe testit të proporcionalitetit do të kenë një udhëzues unik ligjor, në vend që të operojnë me dy ligje të ndara që mund të krijojnë konfuzion dhe paqartësi interpretimi. Një sistem i integruar zvogëlon kostot dhe ngarkesën administrative, duke bërë që profesionistët, institucionet arsimore dhe urdhrat profesionalë të kenë procedura më të lehta për zbatim dhe mbikëqyrje.

Së treti, ndarja e këtyre dy Direktivave në ligje të veçanta mund të çojë në mospërputhje midis procedurave për njohjen e kualifikimeve dhe mekanizmit të testit të proporcionalitetit, duke krijuar rrezikun e interpretimeve të ndryshme nga institucionet përgjegjëse. Kjo do të sillte dallime në afatet dhe mënyrën e implementimit, duke shkaktuar vonesa në njohjen e kualifikimeve dhe përshkallëzimin e mosmarrëveshjeve administrative. Gjithashtu, ndarja do të krijonte paqartësi në ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet institucioneve, duke vështirësuar koordinimin e MA me urdhrat profesionalë dhe ministritë e tjera të linjës. Integrimi i të dy Direktivave në një ligj të vetëm garanton që të gjitha procedurat, kriteret dhe afatet kohore të jenë të njëjta, duke shmangur mospërputhjet dhe zbatimin e pjesshëm të reformës.

Një tjetër arsye pse ky opsion është më i favorshëm lidhet me përputhjen më të mirë me *acquis* dhe praktikën e BE-së. Disa shtete anëtare të BE-së që kanë transpozuar këto dy Direktiva kanë zgjedhur t'i integrojnë ato në një ligj të vetëm për të ruajtur unitetin dhe qëndrueshmërinë e kuadrit rregullator mbi profesionet e rregulluara. Duke ndjekur këtë model, Shqipëria jo vetëm përmirëson procesin e integritetit në BE, por gjithashtu demonstroi një përafrim më efikas dhe të strukturuar me *acquis*. Kjo qasje rrit transparencën dhe sigurinë ligjore, duke shmangur pasigurinë që mund të krijojë interpretimi i dy ligjeve të ndara. Për më tepër, krijon një sistem të harmonizuar dhe të kuptueshëm për profesionistët dhe institucionet, duke lehtësuar zbatimin e rregullave të njohjes së kualifikimeve.

Njohja e kualifikimeve është hapi i parë për aksesin në tregun e punës dhe në këtë kuptim përbën bazën e rregullimit të profesioneve të rregulluara. Testi i proporcionalitetit duhet të lidhet ngushtësisht me këto kritere për të siguruar që masat që kufizojnë ushtrimin e profesionit të jenë të justifikuara dhe të balancuara. Integrimi i proporcionalitetit në ligjin për njohjen e kualifikimeve siguron që ky vlerësim të jetë në

vëmendje për zbatuesin që në fazën fillestare të hyrjes në treg, duke shmangur rregullime të panevojshme që mund të bllokojnë mobilitetin profesional. Testi i proporcionalitetit nuk është një mjet për të vendosur kushte mbi ushtrimin e profesionit, por për të siguruar që ato kushte janë të justifikuara dhe në përputhje me të drejtat e lëvizjes së lirë të profesionistëve.

Nga ana tjetër, Shqipëria ka tashmë një ligj për profesionet e rregulluara që daton nga viti 2009, por përafrimi i proporcionalitetit në atë ligj do të kërkonte një rishikim tërësor të tij, duke krijuar komplikime shtesë dhe potencialisht duke bllokuar procesin e përafrimit me BE-në. Për këtë arsye, është më e udhës që proporcionaliteti të përfshihet në ligjin për njohjen e kualifikimeve profesionale, duke e ndërlidhur në mënyrë të natyrshme me standardet e njohjes dhe duke siguruar një aplikim të unifikuar të këtij testi për të gjitha profesionet e rregulluara. Kjo gjithashtu krijon një bazë të qartë për rishikimin e ardhshëm të ligjit për profesionet e rregulluara, duke lehtësuar procesin dhe shmangur nevojën për ndryshime të fragmentuara në periudha të ndryshme kohore.

Duke marrë parasysh se qeveria ka parashikuar që përafrimi i plotë i legjislacionit vendas me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 për testin e proporcionalitetit do të bëhet brenda vitit 2025, opsioni nr. 2 paraqitet si më i volitshmi për realizimin e këtij objekti brenda afateve të parashikuara. Integrimi i këtyre dy Direktivave në një ligj të vetëm lejon një harmonizim më të shpejtë dhe efikas të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, duke siguruar një sistem të qëndrueshëm dhe të qartë për të gjithë aktorët e përfshirë në njohjen dhe rregullimin e profesioneve të rregulluara.

Përmes këtij opsioni arrihen objektivat dhe adresohen problemet që diktojnë nevojën për ndërhyrje me një kosto më të ulët se sa alternativat e tjera të përmendura.

Analiza e kosto – efektivitetit

Opsioni – (jo rregullator) – Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues. Nuk gjen zbatim si pasojë e detyrimit për harmonizim, si parakusht për anëtarësimin në BE.

Opsioni 1, nuk mund të adresojë problemet kryesore të analizuara më lart në mënyrë efektive. Ndërhyrja eventuale në një sërë aktesh të posaçme pas miratimit të një instrumenti koordinues me shtrirje horizontale që përafron Direktivën 2005/36/KE dhe Direktivën (BE) 2018/958 (projektligji i propozuar), synon të shmangë mundësinë e një dështimi rregullator, duke garantuar njësimin e efekteve të ardhura nga ndryshimet e secilit akt dhe transpozimin efektiv të *acquis communautaire* në fushën e njohjes së kualifikimeve. Rrjedhimisht kosto e mbartur e opsionit 1 do të ishte implementimi jo efektiv i *acquis communautaire*, që eventualisht do të rëndonte mbi të gjitha grupet e prekura dhe në veçanti mbi qeverinë dhe autoritetet publike.

Opsioni nr. 3 është më i kushtueshëm se opsioni nr. 2 sepse do të konsistonte në hartimin e dy nismave ligjore, të cilat do të transpozonin dy Direktiva që synojnë të njëjtat efekte në kuadër të tregut të përbashkët.

Opsioni 4 – është më i kushtueshëm se opsioni nr. 2 sepse do të konsistonte në hartimin e dy nismave ligjore (rishikimin pothuaj tërësor të një akti ekzistues dhe akteve nënligjor bazuar në të dhe hartimin e një akti të ri), të cilat do të transpozonin dy Direktiva që synojnë të njëjtat efekte në kuadër të tregut të përbashkët.

Opsioni nr. 2 është më efikas dhe me kosto më të ulët, pasi garanton arritjen e objektivave në mënyrë të organizuar, të përshkallëzuar dhe efektive, duke shmangur dështimet rregullatore.

Analiza me shumë kritere

Kriteret për vlerësimin e opsioneve dhe pesha e secilit sipas rëndësisë relative:

1. Përafrimi me Direktivën 2005/36/KE dhe Direktivën (BE) 2018/958 - 5

2. Realizimi i masës përkatëse në PKIE 2024-2026 - 5
3. Krijimi i premisave për lëvizjen e lirë të profesionistëve shqiptarë në shtetet e BE-së - 5
4. Krijimi i kushteve të përafrimit të legjislacionit sektorial me *acquis communautaire* në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale - 5

Shkalla e performancës është nga 0 në 5, ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4
Përafrimi me Direktivën 2005/36/KE dhe Direktivën (BE) 2018/958	5	n/a	3	5	3	3
Realizimi i masës përkatëse në PKIE 2024-2026	5	n/a	1	5	2	1
Krijimi i premisave për lëvizjen e lirë të profesionistëve shqiptarë në shtetet e BE-së	5	n/a	1	5	4	4
Krijimi i kushteve të përafrimit të legjislacionit sektorial me <i>acquis communautaire</i> në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale	5	n/a	2	5	4	4
Kosto - efektiviteti	5	n/a	2	5	3	3
Pikët			9	25	16	15

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.

MA ka rol kyç në miratimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit horizontal, duke siguruar që përafrimi i legjislacionit vendas me *acquis* të jetë i plotë dhe efektiv. Në veçanti, MA ka përgjegjësi për zbatimin e Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit. Nder detyrat kryesore të MA përmenden:

1. Harmonizimi i legjislacionit horizontal, ku MA është përgjegjëse për:

- Miratimin dhe ndjekjen e projektligjit për përafrimin e legjislacionit mbi njohjen e kualifikimeve profesionale.
- Hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe urdhrat profesionalë, për të siguruar përputhshmërinë me *acquis*.

2. Koordinimi dhe drejtimi i procesit, ku MA garanton që:

- Ministritë e linjës dhe urdhrat profesionalë të zbatojnë detyrimet për regjimin e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve.
- IAL-të të përshtatin programet akademike në përputhje me standardet evropiane, duke mundësuar njohjen automatike të diplomave profesionale dhe integrimin më të lehtë të profesionistëve në tregun e punës.

3. Monitorimi dhe Raportimi mbi Progresin e Zbatimit, ku MA siguron monitorimin dhe raportimin e rregullt mbi ecurinë e reformës, duke përfshirë:

- Raportimin periodik mbi progresin e masave të përcaktuara.
- Përfshirjen e ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe administrative në Planin Kombëtar të Integritetit Evropian (PKIE), duke siguruar koherencë me politikat e përgjithshme të qeverisë.

4. Mbështetja për Institucionet dhe Urdhrat Profesionalë ku MA mbështet institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave të njohjes së kualifikimeve profesionale, duke përfshirë:

- Zbatimin e testeve të proporcionalitetit, duke shmangur pengesa të panevojshme në njohjen e kualifikimeve dhe lehtësimin e hyrjes së profesionistëve në tregun e punës.
- Përshtatjen e standardeve të formimit profesional me kërkesat e BE-së, duke siguruar që profesionistët shqiptarë të jenë konkurrues dhe të njohur në tregun evropian.

MA ka një rol qendror dhe strategjik në harmonizimin e legjislacionit, koordinimin ndërinstitutional dhe zbatimin e reformave për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Zbatimi i ligjit horizontal nuk mund të realizohet pa një kornizë të plotë rregullatore, e cila sigurohet përmes hartimit dhe miratimit të akteve të tjera nënligjore.

MA, në koordinim me institucionet e tjera të përfshira do të jete përgjegjës të sigurojë që ky proces të zbatohet në mënyrë të plotë dhe efektive, duke krijuar një sistem të besueshëm, të qënrueshëm dhe të harmonizuar për njohjen e kualifikimeve profesionale në Shqipëri.

Institucionet që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të siguruar që realizimin e procesit në mënyrë të plotë dhe efektive, duke mbuluar të gjitha profesionet e rregulluara dhe sektorët përkatës, si janë identifikuar në procesin e *screening*, janë:

- Ministria e Arsimit
- Ministria e Financave
- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit
- Ministria e Mjedisit
- Dhoma Kombëtare e Zejtarisë
- Urdhri i Veterinerëve
- Urdhri i Mjekëve
- Urdhri i Infermierëve
- Urdhri i Farmacistëve
- Urdhri i Stomatologëve
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë

Në këtë kontekst, MA do të udhëheqë miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit horizontal, si dhe të akteve të tjera nënligjore që do të sigurojnë përafrimin e plotë me *acquis*.

- Ministrinë e linjës do të kenë rol kyç në zbatimin e masave specifike për profesionet që mbikëqyrin, duke garantuar integrimin e standardeve të BE-së në sistemin kombëtar.

- Urdhrat profesionalë dhe dhomat e specializuara do të ndihmojnë në zbatimin e rregullave të njohjes dhe përshtatjes së kualifikimeve profesionale, duke ofruar udhëzime dhe mekanizma rregullues për profesionistët e rregulluar.

Në funksion të një zbatimi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të ligjit horizontal, është e nevojshme të adresohen sfidat dhe boshllëqet ekzistuese:

- **(i)** Mungesa e të dhënave të sakta mbi profesionet e rregulluara;
- **(ii)** Kapacitetet e kufizuara për vlerësime të testit të proporcionalitetit;
- **(iii)** Rezistenca institucionale ndaj ndryshimeve strukturore apo procedurale;
- **(iv)** Paaqartësia në përkufizimet sektoriale të disa profesioneve.

Nevoja për trajnime dhe forcim kapacitetesh

MA, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe institucionet përkatëse, do të duhet të sigurojë:

- Programe të posaçme trajnimi për administrimin e procedurave të njohjes së kualifikimeve;
- Forcim të kapaciteteve teknike për kryerjen e testeve të proporcionalitetit dhe përdorimin e platformave evropiane për bashkëpunim administrativ (si IMI).

Mekanizmat e koordinimit dhe fazat e zbatimit

Për të garantuar efektivitet, propozohet ndërtimi i mekanizmave të mëposhtëm:

- **Grupi ndërministror i koordinuar nga MA**, me përfaqësim nga ministritë e linjës dhe urdhrat profesionalë;
- **Raportim trimestrial** nga ministritë e linjës dhe rregullatorët përkatës mbi progresin dhe pengesat;
- **Platformë digjitale kombëtare** për ndarjen e praktikave, udhëzimeve dhe statistikave mbi procesin e njohjes;
- **Plan i strukturuar i zbatimit**, i ndarë në pesë faza:
 1. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore;
 2. Ngritja e strukturave të koordinimit institucional;
 3. Trajnimi i aktorëve të përfshirë;
 4. Fillimi i zbatimit në praktikë;
 5. Monitorimi dhe rishikimi periodik i zbatimit të ligjit horizontal.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Për të monitoruar zbatimin efektiv të kuadrit të ri ligjor dhe për të vlerësuar rezultatet në mënyrë objektive, përcaktohen tregues të matshëm, të tillë si:

- **(i) Numri i profesioneve për të cilat është vendosur dhe funksionon një sistem i përditësuar njohjeje;**
- **(ii) Numri i testeve të proporcionalitetit të kryera dhe dokumentuara nga institucionet përgjegjëse;**
- **(iii) Koha mesatare e përfundimit të procedurës së njohjes së një kualifikimi profesional, nga momenti i aplikimit deri në marrjen e vendimit;**
- **(iv) Numri dhe natyra e raportimeve pozitive në sistemin IMI, kur Shqipëria të ketë akses të plotë si vend kandidat në bashkëpunim me Komisionin Evropian.**

Të dhënat për këta tregues do të shërbejnë si bazë për vlerësim të vazhdueshëm dhe për identifikimin e zonave problematike ose të suksesshme në zbatim.

2. Vlerësimi ex post (pas zbatimit)

Për të analizuar ndikimin real të reformës dhe funksionimin e mekanizmave të rinj, planifikohet realizimi i një vlerësimi ex post:

- Ky vlerësim do të zhvillohet 12 muaj pas hyrjes në fuqi të akteve nënligjore, dhe do të përfshijë aspekte të zbatimit, koordinimit institucional dhe ndikimit në njohjen reale të kualifikimeve.
- MA do të udhëheqë këtë proces në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe urdhrat profesionalë.
- Pjesë e vlerësimit mund të jetë edhe angazhimi i një pale të tretë të pavarur, si një institucion akademik, agjenci teknike ose një donator që mbështet integrimin evropian, për të garantuar një analizë objektive dhe të besueshme.

3. Përgjegjësitë për monitorimin dhe vlerësimin

Për të siguruar funksionimin e mekanizmit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës përcaktohen qartë përgjegjësitë ndërinstitucionale:

- Urdhrat profesionalë dhe ministritë e linjës janë përgjegjës për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të para mbi zbatimin në sektorët përkatës;
- MA përpunon, konsolidon dhe analizon të dhënat në nivel qendror, duke nxjerrë raportime periodike për progresin e përgjithshëm dhe duke identifikuar nevojat për ndërhyrje korrigjuese.

Ky ndarje e qartë e përgjegjësiave synon të shmangë pasaktësitë dhe vonesat, si dhe të garantojë që vendimmarrja të mbështetet në evidencë.

4. Raportimi në PKIE dhe Progres Raport

Treguesit e zbatimit dhe progresit do të përfshihen në:

- Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), si pjesë e detyrimeve vjetore të Shqipërisë në procesin e përafrimit me *acquis*;
- Raportet zyrtare të progresit që i dërgohen Komisionit Evropian, përfshirë Raportin Vjetor të Progresit dhe raportimet për Nënkomitetin për Arsim dhe Punësim në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA).

Kjo do të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie për zbatimin real të detyrimeve të Shqipërisë, si dhe do të lehtësojë vlerësimin nga institucionet evropiane për përparimin e bërë në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale dhe reformimit të profesioneve të rregulluara.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë	-									
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për bizneset - në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për grupet e tjera - një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto në total	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për buxhetin – një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për grupet e tjera – një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet për biznesin – një herë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimet totale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	-									
Vlera prezente aktuale e kostos në total	-									
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	-									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	-	-	-
Opsioni 2	-	-	-
Opsioni 3	-	-	-

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI